www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2024 – Numri: 104

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 24 qershor 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 378, datë 12.6.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rivitalizimi urban i bulevardit Maliq–Drithas"	11055
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 387, datë 12.6.2024	Për kriteret për përdorimin e tokës bujqësore, për kryerjen e aktivitetit agrifotovoltaik dhe eolik në tokat bujqësore, procedurat për monitorimin e ushtrimit të aktivitetit, përfshirë masat për shkelje të kushteve të ushtrimit të aktivitetit dhe përcaktimin e tarifës.....	11058
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 19.6.2024	Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Shkodër, të pronës me emërtimin "Agjencia Rrenc", me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)", të ndryshuar.....	11060
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 19.6.2024	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar.....	11063
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 399, datë 19.6.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 41, datë 24.1.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2025–2027".....	11076
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 19.6.2024	Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike.....	11079
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 19.6.2024	Për përcaktimin e procedurave, kritereve dhe rregullave për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegrimit social	11081

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 19.6.2024	Për autorizimin e ministrit të Drejtësisë të negociojë drejtpërdrejt me subjektin ndërkombëtar G37 Chambers, për ofrimin e shërbimit të konsulencës për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave që duhet të mblidhen nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim vlerësimin e fushave të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit dhe për hartimin e metodologjisë për mënyrën e vlerësimit e të ndjekjes në vazhdimësi të zbatimit të këtyre rekomandimeve.....	11084
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 403, datë 19.6.2024	Për miratimin e rregullores "Nivelet e lejuara të radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor për mbrojtjen e shëndetit publik.....	11085
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 404, datë 19.6.2024	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për marrjen e masave parandaluese, për përhapjen e zjarreve në toka bujqësore.....	11111
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 19.6.2024	Për dhënien e statusit të veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special" aplikuesit "*Grand Hotel* Borsh" sh.p.k.....	11112
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 19.6.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 494, datë 24.8.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake".....	11113
Urdhër i ministrit të Financave nr. 72, datë 31.5.2024	Për zëvendësim të përkohshëm në detyrë.....	11124
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 40, datë 14.5.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.....	11125
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 682/6, datë 19.6.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave të qytetit Fushë-Krujë"	11138

VENDIM
Nr. 378, datë 12.6.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIVITALIZIMI URBAN I BULEVARDIT MALIQ–DRITHAS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rivitalizimi urban i bulevardit Maliq–Drithas".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Maliq.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall" dhe "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 133 930 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 133 930 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekësh, përballohet nga Bashkia Maliq.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Maliq.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Maliq.

8. Bashkia Maliq kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Maliq.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Maliq për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Maliq për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Maliq, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Maliq, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK "RIVITALIZIMI URBAN I BULEVARDIT MALIQ–DRITHAS"

Nr.	Të dhënat e pronësisë			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimet për shpronësim, sipas llojit të pasurisë							Shënime
											"Arë"			"Truall"				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	"Arë" (m²)	"Truall" (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)	Vlera totale (lekë)	
1	Gafer Albana Anesti Hamide	Seit Seit Seit Seit	Mersinllari Mersinllari Mersinllari Mersinllari	Libonik	2445	14/1	Truall	15		15				15	200	3,000.0	3,000.0	Konfirmuar nga ASHK-ja. Shënim. "Ka lidhje me pasurinë 214/14. Sqarim: Kjo pasuri është kufitare me pasurinë nr. 14/1 dhe nuk preket nga shpronësimi".
2	Shaban Ylli Naile Zamir Gezim	Qemal	Ali Ali Ali AliAli	Libonik	2445	15/30	Truall	32		32				32	200	6,400.0	6,400.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
3	Andrea Erigena	Belul Astrit	Topa Topa	Libonik	2445	15/19	Truall	15.5		15.5				15.5	200	3,100.0	3,100.0	Konfirmuar nga ASHK-ja. Shënim. "Mbi këtë pasuri ndodhet pjesërisht ndërtesa 15/25-Nd". Sqarim: Sipas procesverbalit të mbajtur më datë 8.3.2022, nga grupi i punës, Bashkia Maliq, të ngritur me urdhrin nr. 109, datë 7.3.2022, pasuria nr. 15/25-ND, është prishur nuk ekziston, dhe për rrjedhojë nuk është bërë përllogaritja e vlerës së objektit.
4	Caush	Bashkim	Hamzaj	Libonik	2445	15/21	Truall	15		15				15	200	3,000.0	3,000.0	Konfirmuar nga ASHK
5	Vasil	Petro	Talka	Libonik	2445	511/15	Truall	38		38				38	200	7,600.0	7,600.0	Konfirmuar nga ASHK-ja Shënim. "Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. 511/14-Nd". Sqarim: kjo pasuri nuk preket nga projekti.
6	Shaban Ylli Naile Zamir Gezim	Qemal	Ali Ali Ali Ali Ali	Libonik	2445	511/9	Truall	118		118				118	200	23,600.0	23,600.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.

7	Fatmir	Zeni	Agolli	Libonik	2445	31/14	Truall	119		119				119	200	23,800.0	23,800.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
8	Andon Leonora	Nevrus Osman	Demollari Demollari	Libonik	2445	39/41	Arë	39	39		39	170	6630				6,630.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
9	Angjelo	Veis	Demollari	Libonik	2445	39/32	Arë	40.6	40.6		41	170	6970				6,970.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
10	Merko	Mehmet	Merko	Libonik	2445	39/40	Arë	18.7	18.7		19	170	3230				3,230.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
11	Arben	Habil	Vila	Libonik	2445	39/43	Arë	25	25		25	170	4250				4,250.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
12	Petro	Fejzi	Mirashi	Libonik	2445	89/13	Arë + truall	33	33	33				33	200	6,600.0	6,600.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
13	Mondi Vjollca	Leko Fejzi	Bebri Bebri	Libonik	2445	89/280	Truall	20		20				20	200	4,000.0	4,000.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
14	Dituri Satber Fluturim Ali	Besim Besim Besim Besim	Tafili Tafili Tafili Tafili	Libonik	2445	89/145	Truall	44		44				44	200	8,800.0	8,800.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
15	Gramos	Isuf	Vila	Libonik	2445	39/24	Arë	35	35		35	170	5950				5,950.0	Konfirmuar nga ASHK-ja. Bazuar në shkresën nr. 577 prot., datë 25.9.2019, administruar pranë ASHK-Korçë me nr. 6333 prot., datë 27.9.2019, të zyrës Përmbarimore Korçë. Për vendosjen e sekuestros konservative, vendoset sekuesto konservative mbi pjesën takuese të Gramos Vila.
16	Fondacioni O.A.C.A			Libonik	2445	39/25	Truall	40		40				40	200	8,000.0	8,000.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
17	Alfred	Avni	Vila	Libonik	2445	35/52	Truall	6		6				6	200	1,200.0	1,200.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
18	Anesti	Seit	Mersinllari	Libonik	2445	14/2	Truall	39		39				39	200	7,800.0	7,800.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
Vlera totale																	**133,930.0**	

VENDIM
Nr. 387, datë 12.6.2024

PËR KRITERET PËR PËRDORIMIN E TOKËS BUJQËSORE, PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT AGRIFOTOVOLTAIK DHE EOLIK NË TOKAT BUJQËSORE, PROCEDURAT PËR MONITORIMIN E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT, PËRFSHIRË MASAT PËR SHKELJE TË KUSHTEVE TË USHTRIMIT TË AKTIVITETIT DHE PËRCAKTIMIN E TARIFËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "d", të pikës 5, të nenit 14, të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Për qëllime të këtij vendimi, termat e përdorur në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, dhe në legjislacionin e ushtrimit të aktivitetit të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme kanë të njëjtin kuptim.

2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Fermer", individi i regjistruar në regjistrin e fermës ose subjekti tregtar që ushtron aktivitet bujqësor dhe i regjistruar në regjistrin e fermës, që kanë në pronësi ose posedim tokë bujqësore;

b) "Investitor", subjekti, i cili mund të jetë edhe fermer, që zhvillon veprimtari tregtare dhe në fushën energjetike dhe bujqësore, sipas legjislacionit shqiptar, i cili ka në pronësi një tokë bujqësore të llojit "arë", me vërtetim boniteti nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës 7 dhe/ose 8, ose deri në 8 dhe/ose një kontratë, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë për këto lloj pasurish, që do të përdoret për ndërtimin e infrastrukturës dhe veprave ndihmëse për zhvillimin, prodhimin, tregtimin, shfrytëzimin, operimin, shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme agrifotovoltaike dhe/ose eolike;

c) "Tokë bujqësore me bonitet", toka bujqësore, që në regjistrat kadastralë figuron si tokë bujqësore dhe nga dokumentet në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes në qark ka bonitet të vlerësuar nga 1 deri në 10;

ç) "Kulturat tipike të zonës", kulturat e përcaktuara nga agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor, në nivel bashkie dhe të publikuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

II. KRITERET E PËRDORIMIT TË TOKËS BUJQËSORE

1. Kriteret për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë së rinovueshme agrifotovoltaike në tokat bujqësore me bonitet 7 dhe 8, dhe eolike në tokat bujqësore me bonitet deri në 8 janë, si më poshtë vijon:

a) Ushtrimi i aktivitetit bujqësor të jetë në mënyrë të pandërprerë për çdo vit. Para aplikimit për pajisjen me të drejtën e ndërtimit të burimit rigjenerues në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, investitori paraqet për miratim në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural planin e biznesit, ku përcaktohen kulturat bujqësore, tipike të zonës, që kultivohen, prodhimi bujqësor në sasi dhe informacion, për plotësimin e kritereve të tjera. Plani i biznesit dhe miratimi nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural depozitohen në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në momentin që investitori aplikon për pajisjen me të drejtën e ndërtimit të kapacitetit të ri gjenerues, sipas legjislacionit përkatës;

b) Sistemet e paneleve fotovoltaike, që do të instalohen në tokë bujqësore, me bonitet 7 dhe 8, të përfshijnë një sistem të integruar, të sigurojnë raportim të parametrave të përdorimit të ujit, shëndetin e kulturave të mbjella, ruajtjen e shëndetit të tokës bujqësore nëpërmjet zbatimit të një praktike të mirë bujqësore, sipas përcaktimit të nenit 16, të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar;

c) Instalimi i moduleve fotovoltaike të ndjekë drejtimin e punimit të mekanizuar të tokës dhe të mos pengojë përdorimin e mekanikës, duke respektuar këto kritere:

i. largësia e moduleve të vendosura në drejtimin e punimit të tokës të jetë jo më pak se 4 (katër) metra;

ii. largësia e rreshtave të moduleve fotovoltaike të jetë jo më pak se 4 (katër) metra;

iii. lartësia e moduleve fotovoltaike të jetë jo më pak se 3 (tre) metra;

iv. tërësia e sipërfaqes së moduleve, që prodhojnë energji të rinovueshme, të jetë jo më e madhe se 40 % e tërësisë së sipërfaqes së parcelës ku vendosen panelet;

v. në rastin e vendosjes vertikale të moduleve, të respektohet largësia e rreshtave në gjatësi të parcelës, jo më pak se 7 (shtatë) metra;

ç) Sipërfaqja e tokës në dispozicion të aktivitetit bujqësor nuk mund të jetë më pak se 60 % e saj;

d) Instalimet e infrastrukturës së vendosjes së paneleve të jenë të çmontueshme dhe të mos përdoren materiale, të cilat dëmtojnë tokën;

dh) Sipërfaqja e moduleve fotovoltaike në tokë bujqësore për aktivitet agrofotovoltaik të lejojë jo më pak se 60 % dritë në të mbjella, duke siguruar diellzimin e nevojshëm për kulturat bujqësore;

e) Prodhimi bujqësor të mos jetë më i vogël se 70 % e prodhimit bujqësor, para instalimit të paneleve ose rendimentit të referencës, i cili llogaritet duke përdorur mesataren trevjeçare, në rang bashkie. Në rastet e mungesës së të dhënave të prodhimit bujqësor, përdoren të dhënat që publikohen nga agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor dhe të konfirmuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bazuar në bonitetin e tokës bujqësore.

2. Kriteret për ushtrimin e aktivitetit për ndërtimin e infrastrukturës dhe veprave ndihmëse për zhvillimin, prodhimin, tregtimin, shfrytëzimin, operimin, shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme eolike në tokat bujqësore, me bonitet deri në 8, janë, si më poshtë vijon:

a) ushtrimi i aktivitetit bujqësor të jetë në mënyrë të pandërprerë për çdo vit, bazuar në planin e biznesit;

b) largësia e turbinave eolike të jetë jo më pak se 200 (dyqind) metra;

c) sipërfaqja e tokës në dispozicion të aktivitetit bujqësor nuk mund të jetë më pak se 70 % e saj.

3. Investitorët pajisen me të drejtën e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, sipas legjislacionit sektorial të energjisë së rinovueshme. Investitorët paraqesin për pajisjen me të drejtë ndërtimi të kapaciteteve të reja gjeneruese dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) planvendosjen e paneleve ose turbinave eolike dhe planvendosjen e infrastrukturës ndihmëse, nëse është e parashikuar një e tillë në projekt, në parcelën ku do kryhet ndërtimi, e cila shërben dhe për miratimin e lejes së ndërtimit;

b) relacionin teknik, ku përfshihen në detaje zërat e punimeve, sipërfaqja totale e paneleve ose turbinave eolike dhe përqindja në raport me sipërfaqen e parcelës, sipërfaqja e objektit të infrastrukturës ndihmëse, zërat e punimeve, plotësimi i kushteve, sipas kreut 2, të këtij vendimi;

c) miratimin paraprak nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

4. Ndryshimi i resursit, nga tokë bujqësore në truall, lejohet vetëm për objektin për vendosjen e infrastrukturës ndihmëse që ndërtohet, nëse ky ndërtim parashikohet. Resursi i tokës bujqësore nuk ndryshon për sipërfaqen e zënë me instalimet e paneleve të prodhimit të energjisë.

III. PROCEDURAT E MONITORIMIT TË AKTIVITETIT

1. Me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe të ministrit përgjegjës për rendin, me qëllim monitorimin dhe garantimin e kultivimit dhe mbrojtjes së tokës bujqësore, ngrihen njësi të përhershme të monitorimit me nga 1 (një) përfaqësues nga institucionet e mëposhtme:

a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

b) agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor;

c) Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës në ministri ose në qark;

ç) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

2. Njësitë kryejnë monitorime për subjektet e licencuara, jo më pak se 2 (dy) herë në vit, për zbatimin e detyrimeve ligjore, të këtij vendimi, dhe prodhimin bujqësor në sasi. Raportet e monitorimit depozitohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në Agjencinë e Zhvillimit të Territorit dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Raportet periodike përfshijnë:

a) sipërfaqen e mbjellë dhe prodhimin bujqësor të realizuar çdo vit dhe atë 3-vjeçar;

b) zbatimin e praktikave të mira bujqësore;

c) zbatimin në vijimësi të lejes së ndërtimit dhe vendosjen e infrastrukturës së prodhimit të energjisë, sipas planvendosjes dhe lejes së ndërtimit;

ç) të dhëna të tjera, bazuar në detyrimet e pronarëve ose poseduesve nga legjislacioni për mbrojtjen e tokës dhe për shëndetin e bimëve.

IV. MASAT PËR SHKELJE TË USHTRIMIT TË AKTIVITETIT

1. Njësia, në rast se gjatë monitorimit konstaton ushtrim të aktivitetit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe me ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, lidhur me këtë aktivitet, propozon marrjen e masave të mëposhtme:

a) Vendosjen e gjobës, nëse konstaton mosrealizim të planit të biznesit, në vlerën:

i. 100 000 (njëqind mijë) lekë për dynym;

ii. 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për dynym, për sipërfaqen mbi 1 ha;

b) Shfuqizimin e lejes së ndërtimit nga autoriteti që e ka miratuar për shkelje të lejes së ndërtimit ose mungesës së prodhimit, në raporte monitorimi 3-vjeçare.

2. Masat i propozohen:

a) Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës për kundërvajtje, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar;

b) Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për shkelje të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit;

c) Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për penalitetet e parashikuara në këtë vendim, që lidhen me ndërprerjen e aktivitetit bujqësor.

3. Në rast të shfuqizimit të lejes së ndërtimit, shpenzimet për rehabilitimin e tokës dhe heqjen e infrastrukturës, sipas moduleve përballohen nga subjekti që i ka vendosur.

V. TARIFA PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT

1. Tarifa, që paguhet për energjinë që prodhohet, është e barabartë me 1 % të vlerës së energjisë së prodhuar.

2. Pagesa *royalty*, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar, për projektet agrifotovoltaike dhe eolike në tokat bujqësore, me bonitet deri në 8, të jetë 1% e prodhimit, në vlerë monetare.

3. Vlera e tarifës derdhet nga subjektet në buxhetin e shtetit, për zërin e mbështetjes së bujqësisë dhe zhvillimit rural, brenda muajit mars, të vitit pasardhës. Vlera e gjobave derdhet 100 % në buxhetin e shtetit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 393, datë 19.6.2024

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK BASHKIA SHKODËR, TË PRONËS ME EMËRTIMIN "AGJENCIA RRENC", ME VENDNDODHJE NË RRENC, SHKODËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË SHTETIT)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr.

8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Shkodër, të pronës, me emërtimin "Agjencia Rrenc", me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, me numër pasurie 19/2, zona kadastrale 3168, Shkodër, me sipërfaqe totale 31 165 (tridhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) m^2, sipas plan-rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për realizimin e projektit të ndërtimit të strehëzës së qenve endacakë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)", të ndryshuar, hiqet prona, me emërtimin "Agjencia Rrenc", me vendndodhje në Rrenc, Shkodër.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës".

4. Bashkisë Shkodër i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ia japë atë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Shkodër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



PLAN RILEVIMI
Prona "Agjencia Rrenc" Rrenc, Shkodër

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË MM (DPRMSH) Datë 26 /02/2024 QËLLIMI: Transferim nga MM (DPRMSH) te Bashkia Shkodër

VENDNDODHJA
Bashkia Shkodër ZVASHK Shkodër Nr.Pasurisë 19/2 Z.K 3168 Indeksi i Hartës K-34-64- (210-A,B)

TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë _____ Sip e pasurisë 31165m² Sip e gjurmës së ndërtimit 2353.1m² Nr. kateve Nr. pemeve____

Nord =4658661.76 East = 462263.66 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH) Nord =4658661.76 East = 462703.57

SHPJEGUESE:

Kufiri sipas Hartes Kadastrale dhe Faktit
Sip.e pergj. = 31165m²
Objektet sipas faktit
Sip. e përgj. e gjurmës së ndërtimit të objekteve = 2353.1m² (objektet janë të rrënuara)

Nord =4658310.69 East = 462263.66 SH 1: 2500 METRA Nord =4658310.69 East = 462703.57

NR	ORJENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Veri			Pasuria nr.19	K51726024H
2	Lindje			Pasuria nr.19; 328	
3	Jug			Pasuria nr.19/4; 328	
4	Perëndim			Pasuria nr.19/4	

REALIZOI PËR IGJIU
Topograf Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI MArk. Teuta **KANXHERI**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti_____
DVASHK_____
Nënshkrimi_____
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori_____
Nënshkrimi/ Vula_____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto;
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas gjendjes faktike në terren dhe HTR.
Shënim: Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit nr.344, datë 26.02.2024, bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor, dokumentacionit të pronësisë b/lidhur shkresës (Çertifikatë Registrimi Pronësie, Kartela e Pasurisë së Paluajtshme,HTR)

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË MM (DPRMSH)
MIRATOHET
Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit
Robert **HYSENLLARI**

VENDIM
Nr. 397, datë 19.6.2024

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 25, të kreut I, pas fjalëve "... (CFSP) 2024/746 ..." shtohen "... (CFSP) 2024/1470 ...".

2. Në aneksin 25, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2024/1470, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Gazeta Zyrtare
shkimit Evropian

AL
seritë L

2024/1470

22.5.2024

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2024/1470

i datës 21 maj 2024

ndryshimi i Vendimit 2014/512/CFSP në lidhje me masat kufizuese në funksion të veprimeve të Rusisë për destabilizimin e situatës në Ukrainë

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punëve të Jashtme dhe të

Sigurisë,

Ndërsa:

(1) Më 31 korrik 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/512/CFSP ([1]).

(2) Bashkimi mbetet i palëkundur në mbështetjen e tij për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës.

(3) Më 24 shkurt 2022, Presidenti i Federatës Ruse njoftoi një operacion ushtarak në Ukrainë dhe forcat e armatosura të Rusisë filluan një agresion ushtarak të paprovokuar dhe të pajustifikuar kundër Ukrainës. Kjo luftë e paligjshme agresioni është një shkelje e hapur e integritetit territorial, sovranitetit dhe pavarësisë së Ukrainës, si dhe një shkelje e ndalimit të përdorimit të forcës të parashikuar në nenin 2(4) të Kartës së Kombeve të Bashkuara (OKB), e cila është një rregull themelor i së drejtës ndërkombëtare, dhe i parimeve të tjera të Kartës së OKB-së (Karta e OKB-së).

(4) Në Rezolutën e saj ES-11/1, të miratuar më 2 mars 2022, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së shprehu keqardhjen më të thellë për agresionin e Federatës Ruse kundër Ukrainës në kundërshtim me nenin 2(4) të Kartës së OKB-së. Në Rezolutën ES-11/4, të miratuar më 12 tetor 2022, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, duke vënë në dukje deklaratën e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të datës 29 shtator 2022, në të cilën ai përmend se çdo aneksim i territorit të një shteti nga një shtet tjetër, që rezulton nga kërcënimi ose përdorimi i forcës, është një shkelje e parimeve të Kartës së OKB-së dhe të drejtës ndërkombëtare, dënoi organizimin nga Federata Ruse të të ashtuquajturave referendume të paligjshme në rajonet brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht të Ukrainës dhe tentativën e aneksimit të paligjshëm të rajoneve Donetsk, Kherson, Luhansk dhe Zaporizhzhia të Ukrainës, pas organizimit të atyre të ashtuquajturave referendume.

(5) Në Rezolutën e saj A/RES/ES-11/5 të datës 15 nëntor 2022, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së shprehu shqetësim të madh për humbjen e jetëve, zhvendosjen e civilëve, shkatërrimin e infrastrukturës dhe burimeve natyrore, humbjen e pronës publike dhe private, dhe fatkeqësinë ekonomike të shkaktuar nga agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës, dhe pranoi se Federata Ruse duhet të mbahet përgjegjëse për çdo shkelje të së drejtës ndërkombëtare në ose kundër Ukrainës, duke përfshirë agresionin e saj në kundërshtim me Kartën e OKB-së, si dhe çdo shkelje të të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, dhe se ajo duhet të bartë pasojat ligjore të të gjitha akteve të saj të paligjshme ndërkombëtarisht, duke përfshirë kompensimin për dëmtimin, duke përfshirë çdo dëm, të shkaktuar nga akte të tilla.

(6) Në Rezolutën e saj A/ES-11/L.7 të datës 23 shkurt 2023, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së bëri thirrje gjithashtu për respektimin e plotë të palëve në konfliktin e armatosur ndaj detyrimeve të tyre sipas ligjit ndërkombëtar humanitar dhe për një ndërprerje të menjëhershme të sulmeve në infrastrukturën kritike të Ukrainës dhe çdo sulmi të qëllimshëm ndaj objekteve civile, duke përfshirë rezidencat, shkollat dhe spitalet.

(7) Më 28 shkurt 2022, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2022/335 ([2]) për ndryshimin e Vendimit 2014/512/CFSP, i cili ndalonte çdo transaksion në lidhje me menaxhimin e rezervave, si dhe me asetet e Bankës Qendrore të Rusisë, duke përfshirë transaksionet me çdo person juridik, subjekt ose organ që vepron në emër ose në drejtimin e

(1) Vendimi i Këshillit 2014/512/CFSP i 31 korrikut 2014 në lidhje me masat kufizuese në funksion të veprimeve të Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë (OJ L 229, 31.7.2014, f. 13).
(2) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2022/335 i 28 shkurtit 2022 që ndryshon Vendimin 2014/512/CFSP në lidhje me masat kufizuese në funksion të veprimeve të Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë (OJ L 57, 28.2.2022, f. 4).

Bankës Qendrore të Rusisë. Më 9 mars 2022, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2022/395 ([3]) për të përfshirë një ndalim të tillë në lidhje me Fondin Kombëtar të Pasurisë Ruse. Si rezultat i këtyre ndalimeve, asetet përkatëse të mbajtura nga institucionet financiare në Shtetet Anëtare janë 'imobilizuar'.

(8) Siç nënvizohet në konkluzionet e takimit të Këshillit Evropian më 26 dhe 27 tetor 2023, nevojitet një progres vendimtar, në koordinim me partnerët, se si çdo e ardhur e jashtëzakonshme e mbajtur nga subjektet private që rrjedhin drejtpërdrejt nga asetet e imobilizuara të Rusisë, të mund të drejtohet për të mbështetur Ukrainën dhe rimëkëmbjen dhe rindërtimin e saj, në përputhje me detyrimet kontraktuale të zbatueshme dhe në përputhje me të drejtën e Bashkimit dhe ligjin ndërkombëtar. Në konkluzionet e tij, Këshilli Evropian i bëri thirrje Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punëve të Jashtme dhe Sigurisë (Përfaqësuesi i Lartë) dhe Komisionit që të përshpejtojnë punën me synimin për të paraqitur propozime.

(9) Në konkluzionet e tij të 14 dhe 15 dhjetorit 2023, Këshilli Evropian përsëriti dënimin e tij të vendosur të luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, e cila përbën një shkelje të dukshme të Kartës së OKB-së, dhe ripohoi mbështetjen e palëkundur të Bashkimit për pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht dhe të drejtën e saj të natyrshme për vetëmbrojtje kundër agresionit rus.

(10) Në konkluzionet e tij të 1 shkurtit 2024, një takim i posaçëm i Këshillit Evropian nënvizoi nevojën për të siguruar, së bashku me partnerët, mbështetje financiare të qëndrueshme, të parashikueshme dhe të qëndrueshme për Ukrainën për periudhën 2024-2027, dhe arriti në përfundimin se do të krijohet një Lehtësi për Ukrainën për periudhën 2024-2027. Rregullorja (BE) 2024/792 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ([4]) për krijimin e Facilitetit të Ukrainës u miratua më 29 shkurt 2024. Më 5 mars 2024, Komisioni propozoi një Rregullore për krijimin e një Programi Evropian të Industrisë së Mbrojtjes ('EDIP') dhe një kornizë masash për të siguruar disponueshmërinë dhe furnizimin në kohë të produkteve të mbrojtjes ([5]). EDIP duhet të ngrihet për periudhën 2025-2027 dhe përfshin një program bashkëpunimi ("Instrumenti i Mbështetjes së Ukrainës") që synon të kontribuojë në rimëkëmbjen, rindërtimin dhe modernizimin e bazës teknologjike dhe industriale të mbrojtjes së Ukrainës.

(11) Në konkluzionet e tij të 22 marsit 2024, Këshilli Evropian deklaroi se duke pasur parasysh urgjencën e situatës, Bashkimi Evropian është i vendosur të vazhdojë t'i ofrojë Ukrainës dhe popullit të saj të gjithë mbështetjen e nevojshme politike, financiare, ekonomike, humanitare, ushtarake dhe diplomatike për aq kohë sa duhet dhe aq intensivisht sa nevojitet.

(12) Më 12 shkurt 2024, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2024/577 ([6]), duke ndryshuar Vendimin 2014/512/CFSP për të dhënë disa sqarime në lidhje me ndalimin e çdo transaksioni mbi menaxhimin e rezervave dhe aseteve të Bankës Qëndrore të Rusisë, si dhe për të futur masa të mëtejshme.

(13) Vendimi (CFSP) 2024/577 sqaroi se transaksionet e menaxhimit të bilancit të lidhura me aktivet dhe rezervat e Bankës Qendrore të Rusisë, ose të lidhura me aktivet dhe rezervat e çdo personi juridik, entiteti ose organi që vepron në emër ose në Drejtimin e Bankës Qendrore të Rusisë, siç është Fondi Kombëtar i Pasurisë Ruse, nuk janë brenda objektit të ndalimit të transaksioneve që zbatohen që nga data 28 shkurt 2022. Transaksionet e menaxhimit të bilancit që mbeten të autorizuara kanë të bëjnë veçanërisht me ri-investimin bilanceve të parave të gatshme, të akumuluara për shkak të pagesave të imobilizuara të kuponit ose dividendit dhe riblerjes dhe depozitave të maturuara, në përputhje me një politikë të kujdesshme investimi, sipas kërkesave rregullatore në fuqi.

(14) Transaksione të tjera, në veçanti çdo transferim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë për ose në interes të Bankës Qendrore të Rusisë, ose për ose në dobi të çdo personi juridik, subjekti ose organi që vepron në emër ose në drejtimin e, Bankës Qendrore të Rusisë, siç është Fondi Kombëtar i Pasurisë Ruse, mbetet i ndaluar

---

(3) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2022/395 i datës 9 mars 2022 që ndryshon Vendimin 2014/512/CFSP në lidhje me masat kufizuese në funksion të veprimeve të Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë (OJ L 81, 9.3.2022, f. 8).
(4) Rregullorja (BE) 2024/792 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 shkurt 2024 për krijimin e Facilitetit të Ukrainës (OJ L, 2024/792, 29.2.2024, ELI: http://data.europa.eu/ eli/reg/2024/792/oj).
(5) Procedura ndërinstitucionale 2024/0061/COD (https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/HIS/?uri=CELEX:52024PC0150).
(6) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2024/577 i datës 12 shkurt 2024 që ndryshon Vendimin 2014/512/CFSP në lidhje me masat kufizuese në funksion të veprimeve të Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë (OJ L, 2024/577, 14.2.2024, ELI: http://www. ://data.europa.eu/eli/dec/2024/577/oj).

(15) Ndalimi i këtyre transaksioneve të tjera gjeneron një akumulim të jashtëzakonshëm dhe të papritur të bilanceve të parave në bilancet e depozituesve qendrorë të letrave me vlerë sipas kuptimit të Rregullores (BE) Nr. 909/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (7) që zënë një pozicion kyç në shlyerjen dhe mirëmbajtjen qendrore të instrumenteve financiare në Union. Ky akumulim është për shkak të imobilizimit të aktiveve dhe rezervave të Bankës Qendrore të Rusisë, ose atyre të çdo personi juridik, entiteti ose organi që vepron në emër ose nën drejtimin e Bankës Qendrore të Rusisë, si p.sh. Fondi i pasurisë, sepse çdo pagesë e principalit dhe interesit, kuponave, dividenteve ose të ardhurave të tjera për letrat me vlerë në Bankën Qendrore të Rusisë dhe atyre personave, subjekteve dhe organeve është e ndaluar.

(16) Depozitat qendrore të letrave me vlerë janë në një situatë specifike, e cila është e ndryshme nga ajo e institucioneve të tjera financiare, sepse tepricat e parave të ose me klientët e depozitave qendrore të letrave me vlerë zakonisht transferohen jashtë depozitave qendrore të letrave me vlerë përpara fundit të ditës dhe nuk ndodh të japin ndonjë shpërblim për klientët. Gjendjet e parave të mbajtura nga depozituesit qendrorë të letrave me vlerë në lidhje me aktivet e Bankës Qendrore të Rusisë, ose ato të çdo personi juridik, entiteti ose organi që vepron në emër ose nën drejtimin e Bankës Qendrore të Rusisë, si p.sh. Fondi Kombëtar i Pasurisë Ruse, i grumbulluar për shkak të masave kufizuese, më pas duhet të menaxhohet me kujdes nga depozituesit qendrorë të letrave me vlerë. Kjo rezulton në gjenerimin e të hyrave të papritura dhe të jashtëzakonshme.

(17) Të ardhurat e papritura dhe të jashtëzakonshme nuk duhet t'i vihen në dispozicion Bankës Qendrore të Rusisë sipas rregullave në fuqi, edhe pas ndërprerjes së ndalimit të transaksionit. Kështu, ato nuk përbëjnë asete sovrane. Prandaj, rregullat për mbrojtjen e aseteve sovrane nuk janë të zbatueshme për këto të ardhura.

(18) Për më tepër, meqenëse ato të ardhura të papritura dhe të jashtëzakonshme rezultojnë domosdoshmërisht nga zbatimi i masave kufizuese, në veçanti ndalimi i përcaktuar në nenin 1a(4) të Vendimit 2014/512/CFSP dhe nenin 5a(4) të Rregullores (BE) Nr 833/2014 (8), depozituesit qendrorë të letrave me vlerë nuk mund të presin që të përfitojnë një përfitim ekonomik të padrejtë dhe të paqëllimtë prej tyre. Bazuar në qëllimin legjitim të ndjekjes së objektivave të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, në veçanti konsolidimin dhe mbështetjen e demokracisë, shtetin e së drejtës, të drejtave të njeriut dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare, ruajtjen e paqes, parandalimin e konflikteve dhe forcimin e sigurisë ndërkombëtare dhe mbrojtjes së popullatës civile, si dhe ndihmës së popullatës që përballet me fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu, Vendimi (CFSP) 2024/577 futi masa shtesë për të siguruar që nga përfitimet e papritura dhe të jashtëzakonshme të depozituesve qendrorë të letrave me vlerë, të grumbulluara në periudhën kohore midis hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe momentit kur masat e përkohshme kufizuese në lidhje me aktivet dhe rezervat e Bankës Qendrore të Rusisë do të ndërpriten, të përfitojnë Ukraina. Këto masa janë pasqyruar në Rregulloren e Këshillit (BE) 2024/576 (9).

(19) Në veçanti, që nga 15 shkurti 2024, depozituesit qendrorë të letrave me vlerë që mbajnë rezerva dhe aktive të Bankës Qendrore të Rusisë me një vlerë totale prej më shumë se 1 milion euro duhet të llogarisin dhe menaxhojnë balancet e tilla të jashtëzakonshme të parave të grumbulluara për shkak të imobilizimit të aktiveve dhe rezervave të Bankës Qendrore të Rusisë veçmas nga aktivitetet e tyre të tjera, dhe gjithashtu të mbajnë të ndara të ardhurat e papritura dhe të jashtëzakonshme të krijuara.

(20) Depozituesve qendrorë të letrave me vlerë ju ndalohet gjithashtu të disponojnë fitimet e tyre neto që pasojnë, siç përcaktohet në përputhje me legjislacionin kombëtar, pas zbritjes së taksës së korporatës sipas regjimit të përgjithshëm të Shtetit Anëtar në fjalë, qoftë me anë të shpërndarjes në formën e dividentëve ose në çfarëdo forme në dobi të aksionarëve ose të ndonjë pale të tretë derisa Këshilli të vendosë për krijimin e një kontributi financiar të mbledhur nga ato fitime neto për të mbështetur Ukrainën. Fitimet neto pasuese të krijuara përpara datës 15 shkurt 2024 mbeten të pakufizuara dhe të disponueshme menjëherë për të absorbuar shpenzimet, rreziqet dhe humbjet e shkaktuara nga depozituesit qendrorë të letrave me vlerë, siç kërkohet nga ligjet e Bashkimit dhe ato kombëtare të zbatueshme për depozituesit qendrorë të letrave me vlerë, duke përfshirë legjislacionin e kujdesshëm kur është e nevojshme.

(7) Rregullorja (BE) Nr. 909/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 korrik 2014 për përmirësimin e shlyerjes së letrave me vlerë në Bashkimin Evropian dhe për depozituesit qendrorë të letrave me vlerë dhe ndryshimin e Direktivave 98/26/KE dhe 2014/65/BE dhe Rregullorja (BE) Nr. 236/2012 (OJ L 257, 28.8.2014, f. 1).

(8) Rregullorja e Këshillit (BE) Nr. 833/2014 e datës 31 korrik 2014 në lidhje me masat kufizuese në funksion të veprimeve të Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë (OJ L 229, 31.7.2014, f. 1).

(9) Rregullorja e Këshillit (BE) 2024/576 e datës 12 shkurt 2024 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 833/2014 në lidhje me masat kufizuese në funksion të veprimeve të Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë (OJ L, 2024/576, 14.2.2024, ELI : http://data.europa.eu/eli/reg/2024/576/oj).

(21) Duke shënuar vitin e dytë të pushtimit ilegal, të pajustifikueshëm dhe të paprovokuar të Rusisë në shkallë të plotë të Ukrainës, udhëheqësit e G7 në deklaratën e tyre të 24 shkurtit 2024 përsëritën mbështetjen e vazhdueshme të vendeve të tyre për të drejtën e Ukrainës për vetëmbrojtje dhe përkushtimin e tyre ndaj sigurisë afatgjatë të Ukrainës, dhe të përkushtuar për të rritur ndihmën e tyre të sigurisë për Ukrainën dhe për të rritur kapacitetet e prodhimit dhe shpërndarjes për të ndihmuar vendin. Ajo deklaratë përshëndeti miratimin e akteve ligjore të Bashkimit në lidhje me të ardhurat e jashtëzakonshme të depozituesve qendrorë të letrave me vlerë të fituara nga aktivet sovrane të palëvizshme të Rusisë dhe inkurajoi hapa të mëtejshëm për të mundësuar përdorimin e tyre, në përputhje me detyrimet kontraktuale në fuqi dhe në përputhje me ligjet në fuqi.

(22) Duke pasur parasysh peshën e situatës dhe në përgjigje të luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, dhe për sa kohë që veprimet e paligjshme të Federatës Ruse vazhdojnë të shkelin rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë, në veçanti, ndalimin e përdorimit të forcës i parashikuar në nenin 2(4) të Kartës së OKB-së, ose të së drejtës ndërkombëtare humanitare, është e përshtatshme të mbahen në fuqi të gjitha masat e vendosura nga Bashkimi. Është gjithashtu e përshtatshme që të merren masa shtesë të jashtëzakonshme që synojnë mbështetjen e Ukrainës dhe rimëkëmbjen dhe rindërtimin e saj, si dhe vetëmbrojtjen e saj kundër agresionit rus, në përputhje me objektivat e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, në veçanti ruajtjen e vlerave të Bashkimit, interesave themelore, sigurinë, pavarësinë dhe integritetin, konsolidimin dhe mbështetjen për demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare, të drejtën për vetëmbrojtje dhe ndalimin e agresionit sipas Kartës së OKB-së, ruajtjen e paqes, parandalimin e konflikteve dhe forcimin e sigurisë ndërkombëtare dhe mbrojtjen e popullatës civile, si dhe ndihmën e popullatës që përballet me fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu, të tilla si ato që iu shkaktuan Ukrainës dhe popullsisë së saj nga lufta e agresionit e Rusisë.

(23) Objektivi i këtyre masave shtesë duhet të jetë në fund të fundit mbështetja e Ukrainës dhe rimëkëmbja dhe rindërtimi i saj, si dhe vetëmbrojtja e saj kundër agresionit rus, duke përfshirë përmes Instrumentit Evropian të Paqes të krijuar me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2021/509 ([10]) dhe programet e Bashkimit të financuara nga buxheti i Bashkimit, si Lehtësia e Ukrainës dhe programet që synojnë rimëkëmbjen, rindërtimin dhe modernizimin e bazës teknologjike dhe industriale të mbrojtjes së Ukrainës. Në përputhje me parimin e sigurisë juridike, masat shtesë duhet të zbatohen nga 15 shkurt 2024.

(24) Në veçanti, është e përshtatshme të përcaktohen rregulla se si fitimet neto që rrjedhin nga të ardhurat e papritura dhe të jashtëzakonshme që grumbullohen tek depozituesit qendrorë të letrave me vlerë si rezultat i zbatimit të masave kufizuese, në veçanti ndalimi i parashikuar në nenin 1a (4) të Vendimit 2014/512/CFSP dhe nenit 5a(4) të Rregullores (BE) Nr. 833/2014, duhet të drejtohen për të mbështetur Ukrainën dhe rimëkëmbjen dhe rindërtimin e saj, si dhe vetëmbrojtjen e saj kundër luftës së agresionit të Rusisë, në përputhje me detyrimet kontraktuale të zbatueshme, dhe në përputhje me të drejtën e Bashkimit dhe atë ndërkombëtar, në koordinim me partnerët. Komisioni duhet të informojë Këshillin dy herë në vit për shumat e transferuara nga depozituesit qendrorë të letrave me vlerë.

(25) Depozituesit qendrorë të letrave me vlerë që mbajnë aktive dhe rezerva me një vlerë totale prej më shumë se 1 milion euro duhet të kontribuojnë nga fitimet e tyre neto korresponduese një kontribut financiar të barabartë me 99,7 % të atyre fitimeve neto të akumuluara që nga 15 shkurti 2024. Kjo normë është justifikuar nga fakti se fitimet neto në fjalë rezultojnë domosdoshmërisht nga zbatimi i masave kufizuese, në veçanti ndalimi i parashikuar në nenin 1a të Vendimit 2014/512/CFSP dhe nenit 5a(4) të Rregullores (BE) Nr. 833/2014, dhe për këtë arsye depozituesit qendrorë të letrave me vlerë nuk mund të presin të përfitojnë një përfitim ekonomik të padrejtë dhe të paqëllimtë prej tyre. Duke pasur parasysh përgjegjësitë e depozituesve qendrorë të letrave me vlerë dhe rolin që ata luajnë në trajtimin e aktiveve të imobilizuara, megjithatë është e përshtatshme të parashikohet që ata të mund të mbajnë një përqindje të kufizuar të fitimeve neto për të siguruar efikasitetin e punës së tyre. Pagesat duhet të bëhen me këste dy herë në vit derisa fitimet e jashtëzakonshme të pushojnë së grumbulluari në bilancet e depozituesve qendrorë të letrave me vlerë për shkak të ndërprerjes së masave kufizuese që ndalojnë transaksionet me aktivet dhe rezervat e Bankës Qendrore të Rusisë.

(26) Depozituesit qendrorë të letrave me vlerë duhet të jenë në gjendje të mbajnë përkohësisht një aksion jo më shumë se 10% të kontributit financiar në funksion të përputhjes me kërkesat e kapitalit ligjor dhe të menaxhimit të rrezikut në funksion të ndikimit për shkak të luftës në Ukrainë në lidhje me aktivet e mbajtura nga depozituesit qendrorë të letrave me vlerë. Nëse kjo pjesë bëhet e pamjaftueshme në të ardhmen, duhet të jetë e mundur që depozituesit qendrorë të letrave me vlerë t'i paraqesin autoritetit kombëtar mbikëqyrës një kërkesë të justifikuar siç duhet për të mbajtur një përqindje shtesë të kontributit financiar të duhur. Mbajtja e një përqindje shtesë mund të autorizohet vetëm nëse është rreptësisht e nevojshme që të respektohen kërkesat e menaxhimit të rrezikut në funksion të ndikimit të luftës në Ukrainë në lidhje me aktivet e mbajtura nga depozituesit qendrorë të letrave me vlerë.

([10]) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2021/509 i datës 22 mars 2021 për krijimin e një Instrumenti Evropian të Paqes dhe shfuqizimin e Vendimit (CFSP) 2015/528 (OJ L 102, 24.3.2021, f. 14).

I.5	***Shpenzime për fondet speciale***	**10.9**	**10.7**	**10.1**	**9.8**	**10.2**	**10.4**	**10.3**	**10.2**
	Sigurime shoqërore	8.1	8.0	7.6	7.4	7.3	7.4	7.4	7.4
	Politika të reja pensionesh	0.0	0.0			0.2	0.2	0.2	0.2
	Bonusi i pensionistit								
	Sigurime shëndetësore	2.6	2.6	2.4	2.4	2.4	2.4	2.3	2.3
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2	0.2	0.2
I.6	***Buxheti lokal***	**3.1**	**2.8**	**2.7**	**3.0**	**3.1**	**3.3**	**3.3**	**3.4**
	Transfertat nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor	1.8	1.4	1.4	1.4	1.5	1.6	1.6	1.6
	Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme	0.0	0.0	0.0	0.0	1.0	1.0	1.0	1.0
	Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (Grant Specifik)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.4	0.5	0.5	0.5
	Transferte sektoriale per pagat		0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	1.3	1.4	1.3	1.5	1.4	1.5	1.5	1.6
	Taksa të ndara	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
	Financimi i huaj vendor dhe te tjera te mbartura	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I.7	***Transferta të tjera***	**1.7**	**1.6**	**1.4**	**1.3**	**1.3**	**1.2**	**1.2**	**1.1**
	Pagesa e papunësisë	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndihma ekonomike dhe politika e femijeve, etj	1.5	1.3	1.2	1.1	1.1	1.0	1.0	1.0
	Kompensim për të përndjekurit politikë	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1
	Bonusi i lindjeve	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	**Fondi rezervë**	**0.7**	**0.0**			**0.1**	**0.2**	**0.1**	**0.3**
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.2
	Rezerve per zgjedhjet	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.1
	Paketa e mbeshtetjes sociale nga COVID	0.7	0.0						
III.	**Shpenzime kapitale**	**6.2**	**6.9**	**5.2**	**5.1**	**5.9**	**5.4**	**5.2**	**5.0**
	Financimi i brendshëm	3.6	3.9	3.0	3.8	3.8	3.5	3.3	2.9
	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Financimi i huaj	1.5	1.4	0.9	0.6	1.6	1.6	1.6	2.0
	Nga te cilat: energjia	0.1	0.1	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
	Trans kapitale për llog. speciale të shpronësimeve								0.1
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit:	1.0	1.6	1.4	0.7	0.4	0.2	0.2	
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (buxheti i shtetit)	0.0	1.6	1.4	0.7	0.4	0.2	0.2	
V.	**Të tjera**	**0.1**	**0.2**	**1.3**	**0.2**				
	Hua e dhene per sis. energj. e te tjera nga burimet e brendshme			0.4					
	Mbeshtetje buxhetore per sektorin energjitik			0.9					
	Transferte kapitale per AIC	0.0	0.2						
VI.	**Fond shpronësimi**	**0.0**	**0.2**	**0.5**	**0.2**				
	DEFIÇITI	**-6.7**	**-4.6**	**-3.7**	**-1.4**	**-2.3**	**-2.4**	**-1.8**	**-1.1**
	FINANCIMI DEFIÇITIT	**6.7**	**4.6**	**3.7**	**1.4**	**2.3**	**2.4**	**1.8**	**1.1**
I.	**I brendshëm**	**3.0**	**-1.0**	**4.1**	**-0.3**	**2.5**	**2.1**	**1.7**	**1.0**
	Të ardhura nga privatizimi	0.0	0.0	0.0	0.0				
	Hua-marrje e brendshme (neto)	2.9	2.6	1.2	0.9	2.1	1.6	1.7	1.1
	Të tjera, nga të cilat:	0.0	-3.6	2.9	-1.2	0.5	0.6	0.1	-0.1
	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	0.9	-3.9	1.9	-1.8	0.0	0.6	0.1	-0.1
	Ndryshimi i gjendjes se depozites sig. Shoq&Shend	0.0	0.0	0.0	0.0	0.4			
II.	**I huaj**	**3.7**	**5.6**	**-0.4**	**1.7**	**-0.2**	**0.2**	**0.1**	**0.1**
	Hua afatgjatë (e marrë)	5.9	5.0	0.5	3.1	1.1	3.6	1.1	3.4
	Per projekte	1.0	0.8	0.5	0.4	1.0	1.0	1.0	1.4
	Eurobond	4.9	4.2		2.7		2.6		1.9
	Nen-hua (Pushteti vendor)		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	0.1	0.1	0.0	0.0				
	Ripagesat	-3.7	-1.8	-1.8	-2.3	-1.9	-4.0	-1.4	-3.7
	Eurobond	-1.9			-0.6		-1.6		-2.5
	Maturim	-1.9					-1.6		-2.5
	Para-blerje				-0.6				
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB, BE, etj)	1.4	2.3	0.8	0.8	0.6	0.7	0.4	0.4
	MEMO:								
	Balanca e përgjithshme (deficiti përgjithshëm)	**-6.7**	**-4.6**	**-3.7**	**-1.4**	**-2.3**	**-2.4**	**-1.8**	**-1.1**
	Balanca korente	**-0.5**	**2.3**	**1.6**	**3.8**	**3.6**	**3.0**	**3.3**	**3.9**
	Balanca primare	**-4.6**	**-2.7**	**-1.8**	**0.7**	**0.3**	**0.5**	**1.0**	**1.7**
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	**0.5**	**3.9**	**0.7**	**2.1**	**1.9**	**1.3**	**1.1**	**1.2**
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	**73.9**	**70.6**	**63.8**	**56.8**	**56.3**	**56.3**	**55.5**	**54.0**
	Borxhi publik BRUTO (stok)	**74.3**	**74.5**	**64.5**	**58.9**	**58.2**	**57.6**	**56.7**	**55.2**
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	71.3	71.5	62.0	57.1	56.2	55.2	54.3	52.8
	I brendshëm (stok)	38.3	36.6	33.3	31.4	31.9	31.9	32.0	31.5
	I huaj (stok)	33.0	35.0	28.7	25.8	24.3	23.4	22.3	21.3
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	3.0	3.0	2.5	1.8	2.1	2.4	2.4	2.3
	Pushteti vendor (stok)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Borxhi publik i garantuar (stok)	3.0	3.0	2.4	1.8	2.0	2.3	2.3	2.3
	PBB nominal	**100.0**	**100.0**	**100.0**	**100.0**	**100.0**	**100.0**	**100.0**	**100.0**

Burimi: Ministria e Financave

VENDIM
Nr. 400, datë 19.6.2024

PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PËRGJITHSHME TË KREDIVE TË REJA PËR KATEGORITË PRIORITARE TË TË PUNËSUARVE PËRFITUES NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 64/3 e 64/5, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të kredive të lehtësuara për administratën publike për vitin 2024 janë, gjithsej, 300 (treqind) dhe ndahen, si më poshtë vijon:

a) 90 (nëntëdhjetë) për Ministrinë e Brendshme;

b) 90 (nëntëdhjetë) për Ministrinë e Mbrojtjes;

c) 30 (tridhjetë) për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

ç) 30 (tridhjetë) për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

d) 45 (dyzet e pesë) për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

dh) 15 (pesëmbëdhjetë) për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Përfituesit sipas shkronjave "b", "c", "d" dhe "dh", të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë të kritereve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Përfituesit sipas shkronjës "a", të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë të kritereve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Përfituesit sipas shkronjës "ç", të pikës 1, të këtij vendimi, janë punonjësit arsimorë në institucionet publike të arsimit parauniversitar, si pjesë e administratës publike, dhe përzgjidhen në bazë të kritereve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Në rast se rezultojnë më shumë kandidatë me pikë të barabarta sesa kuotat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, dhe tabelat bashkëlidhur, përzgjedhja e tyre realizohet sipas sistemit të pikëzimit të përcaktuar nga institucioni përfitues, për të realizuar numrin e kuotave të përcaktuara.

6. Punonjësit e administratës publike të përzgjedhur përfitojnë kredi të lehtësuar me interes 0 (zero) %.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TABELA NR. 1: PIKËZIMI PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR T'U TRAJTUAR ME KREDI TË LEHTËSUAR PËR BLERJEN E BANESËS

	KRITERET E PIKËZIMIT	**100 pikë**
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	**50**
A.	Nuk disponon banesë në pronësi	
B.	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C.	Punonjës, që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor	
D.	Punonjës, që banon në banesë që do të prishet pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	**25**
A.	Punonjës, që ka jo më pak se dy vjet i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
B.	Punonjës, që ka jo më pak se shtatë vjet i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
C.	Punonjës, që i përket kategorisë "familje e re", në kuptim të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar	
Ç.	Punonjës, që i përket kategorisë "të rinj me moshë jo më të madhe se 40 vjeç"	
D.	Familje njëprindërore, që ka në ngarkim fëmijë	
1.3	KUSHTET EKONOMIKE	**25**

A.	I përket kategorisë së pagës, sipas vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave	
B.	I përket kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1	
C.	I përket kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2	

TABELA NR. 2: PIKËZIMI PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR T'U TRAJTUAR ME KREDI TË LEHTËSUAR PËR BLERJEN E BANESËS

	KRITERET E PIKËZIMIT	**100 pikë**
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	**50**
A.	Nuk disponon banesë në pronësi	
B.	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C.	Punonjës, që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor	
Ç.	Punonjës, që banon në banesë që do të prishet pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	**25**
A.	Punonjës, që ka jo më pak se një vit i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit e që bën pjesë në përkufizimin e pikës 54, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social"	
B.	Punonjës, që ka jo më pak se pesë vjet i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
C.	Punonjës, që i përket kategorisë "familje e re", në kuptim të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar	
Ç.	Punonjës, që i përket kategorisë "të rinj me moshë jo më të madhe se 40 vjeç"	
D.	Familje njëprindërore, që ka në ngarkim fëmijë	
1.3	KUSHTET EKONOMIKE	**25**
A.	I përket kategorisë së pagës sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.5.2023; nr. 325, datë 31.5.2023; nr. 200, datë 15.3.2017; nr. 688, datë 18.11.2021; nr. 350, datë 19.4.2017; nr. 321, datë 31.5.2023	
B.	I përket kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1 ose ekuivalente me to	
C.	I përket kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2 ose ekuivalente me to	

TABELA NR. 3: PIKËZIMI PËR TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR T'U TRAJTUAR ME KREDI TË LEHTËSUAR PËR BLERJEN E BANESËS

	KRITERET E PIKËZIMIT	**100 pikë**
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	**50**
A.	Nuk disponon banesë në pronësi	
B.	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C.	Punonjës, që ka humbur banesën si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor	
Ç.	Punonjës, që banon në banesë që do të prishet pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
D.	Punonjës, që banon në banesa në rrezik shembjeje, që ka mbetur ose rrezikon të mbetet i pastrehë, si rezultat i fatkeqësisë natyrore	
1.2	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI	**50**
A.	Punonjës arsimor, i cili, në momentin e aplikimit, është i punësuar me kohëzgjatje të pacaktuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar	
B.	Punonjës, i cili i përket kategorisë "familje e re", në kuptim të ligjit nr. 22/2018, për strehimin social, të ndryshuar, ku të dy bashkëshortët/bashkëjetuesit janë punonjës arsimorë	
C.	Punonjës, i cili punon jashtë vendbanimit mbi 100 kilometra larg e që qëndron në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku ndodhet institucioni publik i arsimit parauniversitar, ku punon	

VENDIM
Nr. 401, datë 19.6.2024

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, KRITEREVE DHE RREGULLAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET RIINTEGRIMIT SOCIAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2, shkronja "h", e 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegrimit social.

2. Programi i riintegrimit social është një program me kohëzgjatje deri në gjashtë muaj, i cili ka qëllim përfshirjen në tregun e punës të punëkërkuesve të papunë nëpërmjet ofrimit të këshillimit të specializuar për punësim, vetëpunësim dhe formim profesional.

II. PROGRAMI

1. Programi zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (në vijim AKPA), në bashkëpunim me institucione të tjera publike dhe organizata jofitimprurëse (në vijim OJF), të cilat kanë në fokus të veprimtarisë së tyre fuqizimin ekonomik të grupeve të disavantazhuara, nëpërmjet ofrimit të këshillimit të specializuar për punësim, vetëpunësim dhe formim profesional, koordinimin dhe referimin në shërbimet e punësimit dhe shërbimet sociale, të cilat ndihmojnë përfituesit të integrohen në tregun e punës.

2. Për zbatimin e këtij programi, AKPA-ja kontrakton OJF-në, nëpërmjet procedurave konkurruese, të përcaktuara në kreun V, të këtij vendimi.

3. OJF-ja zbatuese ofron këshillim të specializuar për integrim në tregun e punës dhe koordinon e referon në punësim, vetëpunësim, formim profesional, si dhe në shërbimet përkatëse sociale.

4. OJF-ja zbatuese garanton ambientet e nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve.

5. Me qëllim zbatimin e programit, për çdo dy grupe përfituesish, OJF-ja e kontraktuar vendos në dispozicion një mbikëqyrës dhe një këshillues për zbatimin e programit.

6. Mbikëqyrësi është personi përgjegjës i ngarkuar me kontrollin e zbatimit të programit, sigurimin e pjesëmarrjes, koordinimin e proceseve me strukturat e punësimit të AKPA-së, si dhe me institucionet e tjera publike të përfshira në zbatimin e këtij programi.

7. Këshilluesi është personi përgjegjës për përpilimin e planit individual të riintegrimit dhe punësimit, organizimin e takimeve individuale dhe në grup, ndjekjen dhe arritjen e objektivave të planit, si dhe ofron mbështetjen në punësim gjatë programit për përfituesit.

8. Plani individual i riintegrimit dhe punësimit përgatitet nga këshilluesi në bashkëpunim me përfituesin e programit dhe zyrën e punës. Plani individual i riintegrimit dhe punësimit përmban analizën e nevojave për punësim të përfituesit, objektivat individualë për punësim dhe afatet kohore të zbatimit.

9. OJF-ja zbatuese ofron shërbimet sipas këtij programi, për jo më shumë se 2 (dy) grupe përfituesish nga programi, secili me nga 20 (njëzet) pjesëmarrës.

10. Secili grup përfituesish takohet me këshilluesin 2 (dy) herë në javë, në një format prej 8 (tetë) takimesh në muaj, me kohëzgjatje 3 (tre) orë për takim. Gjithashtu, këshilluesi kryen edhe 12 (dymbëdhjetë) takime individuale gjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit me secilin pjesëmarrës, me kohëzgjatje një orë për takim, përmbajtja e të cilave detajohet në rregulloren shoqëruese për zbatimin e këtij vendimi.

III. KRITERET PËR PËRFITUESIT DHE ZBATUESIT E PROGRAMIT

1. Përfituesit e këtij programi janë punëkërkuesit e papunë të regjistruar në zyrën e punës, të cilët evidentohen nga ndërveprimi me sistemin tatimor se kanë më shumë se 6 (gjashtë) muaj të papunë (në vijim "përfituesit"). Prioritet kanë përfituesit e skemës së ndihmës ekonomike, anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, gratë që banojnë në njësitë administrative vendore, ku nuk ka struktura vendore punësimi, si dhe punëkërkues të tjerë nga grupet e veçanta.

2. Nëse përfituesi, sipas këtij programi, përfshihet në programe të tjera të nxitjes së punësimit apo punësohet, pjesëmarrja në këtë program ndërpritet.

3. Nëse pjesëmarrja në këtë program ndërpritet gjatë muajit të parë, OJF-ja zbatuese njofton strukturën vendore të punësimit dhe merr konfirmimin për zëvendësimin e pjesëmarrësit të larguar.

4. Personat, që largohen nga programi pa miratimin paraprak të këshilluesit dhe të specialistit përkatës në zyrën e punës, humbasin statusin e punëkërkuesit të papunë.

5. OJF-ja zbatuese e këtij programi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë e regjistruar, prej jo më pak se një viti, sipas legjislacionit në fuqi dhe të kryejë aktivitet, në përputhje me qëllimin e caktuar në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e OJF-ve;

b) të mos jetë në proces shpërndarjeje ose likuidimi;

c) të ketë shlyer detyrimet tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) përfaqësuesi ligjor të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) të ketë selinë ose vendin e ushtrimit të veprimtarisë në qarkun ku do të zbatojë programin;

dh) të ketë kapacitetet dhe përvojën e duhur për zbatimin e programit apo projekteve të punësimit, këshillimit të specializuar dhe shërbimeve sociale;

e) të ketë struktura operative, manuale praktikash dhe procedurash të standardizuara;

ë) personat e angazhuar në menaxhimin dhe zbatimin e këtij programi të kenë të paktën tre vjet eksperiencë në ushtrimin e veprimtarive që janë relevante për këtë program, si dhe në menaxhimin e projekteve të riintegrimit social dhe punësimit të grupeve të disavantazhuara;

f) të vendosë në dispozicion CV-të e mbikëqyrësit dhe këshilluesve që do të angazhojë përgjatë zbatimit të programit.

6. Në rast të largimit të mbikëqyrësit ose këshilluesit, OJF-ja është e detyruar ta zëvendësojë atë brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale të Punësimit dhe siguron që programi ka vazhdimësi normale. Në rast të kundërt, programi ndërpritet dhe OJF-ja nuk ka të drejtë të financohet për pjesën e mbetur.

IV. MBËSHTETJA FINANCIARE

1. Programi i riintegrimit social u ofron punëkërkuesve shërbimet mbështetëse, si edhe një mbështetje financiare për pjesëmarrjen në program, si vijon:

a) pagesë për pjesëmarrje në program, në vlerën prej 8 000 (tetë mijë) lekësh në muaj, për çdo përfitues. Për përfituesit, persona me aftësi të kufizuara, pagesa është 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

b) bonus për shpenzimet e transportit, në rast se distanca e vendbanimit nga vendi i zbatimit të programit është më e madhe se 2 (dy) km, në vlerën prej 1 800 (një mijë e tetëqind) lekësh në muaj;

c) bonus për kujdesin e fëmijëve në ngarkim, deri në fillimin e arsimit bazë, në vlerën prej 4 000 (katër mijë) lekësh në muaj për fëmijë;

ç) bonus për kujdesin e të moshuarve ose të të sëmurëve në ngarkim, në vlerën prej 3 000 (tre mijë) lekësh në muaj për person.

2. OJF-ja, që ofron shërbimet e këtij programi, në favor të përfituesve, mbështetet financiarisht me subvencionim të kostove vijuese:

a) paga e mbikëqyrësit, në vlerën 100% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për dy grupe pjesëmarrësish. Në rastin e një grupi deri në 20 pjesëmarrës, mbikëqyrësi paguhet me 50% të pagës minimale.

b) paga e këshilluesit, në vlerën 100% të pagës mesatare në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për dy grupe pjesëmarrësish. Në rastin e një grupi deri në 20 pjesëmarrës, mbikëqyrësi paguhet me 50% të pagës mesatare.

c) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat i takojnë punëdhënësit, mbi pagat e mbikëqyrësit dhe këshilluesve gjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit;

ç) tarifë për shërbimet administrative dhe organizimin e takimeve në grup, në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për çdo grup.

3. Financimi i programit për OJF-në zbatuese të këtij programi kryhet në formën e një granti, ku mbulohen të gjitha shpenzimet e përmendura në pikat 1 dhe 2, të kreut IV, të këtij vendimi.

4) Granti financiar disbursohet në këste të pagueshme, si më poshtë vijon:

a) kësti i parë: 30% (tridhjetë për qind) e vlerës totale të grantit, të disbursuar me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit;

b) kësti i dytë: 50% (pesëdhjetë për qind) e vlerës totale të grantit, të disbursuar me hartimin dhe miratimin e planit individual të riintegrimit për të gjithë përfituesit;

c) kësti i tretë: 20% (njëzet për qind) e vlerës totale të grantit me përfundimin e kontratës dhe përmbushjes së të gjithë objektivave në programin individual të riintegrimit.

5. Përveç grantit financiar të sipërpërmendur, OJF-ja zbatuese e këtij programi përfiton një bonus, në vlerën prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh për secilin përfitues, nëse ai është punësuar drejtpërdrejt në biznes deri në një afat maksimal prej 6 (gjashtë) muajsh pa shkëputje pas përfundimit të programit, pas marrjes së konfirmimit të punësimit të tij.

V. PROCEDURAT DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË RIINTEGRIMIT SOCIAL

1. AKPA-ja harton dhe publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në platforma të tjera (faqe interneti, media sociale, shtyp) dokumentacionin e nevojshëm që do të përdoret përgjatë procedurave konkurruese për përfitimin e granteve financiare nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat kandidojnë për zbatimin e këtij programi.

2. Në fillim të çdo shpalljeje për aplikim, AKPA-ja harton dhe publikon termat e referencës së bashku me kriteret e aplikimit, fushat dhe vlerat e financimit, si dhe afatet e procedurën e aplikimit.

3. OJF-ja bën kërkesën për përfshirje në program elektronikisht nëpërmjet portalit "*e-Albania",* duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, së bashku me:

a) autorizimin e OJF-së, në favor të strukturave të punësimit të AKPA-së për të kryer verifikimet e dokumenteve dhe të dhënave të aplikimit e të kërkesës për përfshirje në program;

b) vendimin e regjistrimit nga gjykata e rrethit gjyqësor, origjinal ose fotokopje e noterizuar;

c) vërtetimin e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Zyra e Regjistrit të OJF-ve;

ç) vetëdeklarimin mbi plotësimin e kritereve të kërkuara për OJF-të zbatuese, sipas pikës 5, të kreut III, të këtij vendimi, shoqëruar, kur është e mundur, me dokumentet provuese;

d) licencën apo lejen e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë, origjinal ose fotokopje të noterizuar, në rastet kur kjo është e nevojshme;

dh) deklaratën apo marrëveshje partneriteti (origjinale ose fotokopje të noterizuar), në rast se ka partneritet në këtë projektpropozim.

4. Pas marrjes së kërkesës për përfshirje në program, struktura rajonale e punësimit, brenda dhjetë (10) ditëve pune, kryen verifikimin paraprak të përmbushjes të kritereve.

5. Në rast të mangësive, struktura rajonale e punësimit i kërkon OJF-së plotësimin e dokumentacionit nëpërmjet portalit *"e-Albania*", brenda 2 (dy) ditëve pune në seksionin "Dokumentet e mia".

6. Vlerësimi paraprak i kërkesave për përfshirje në program kryhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga Komisioni i Vlerësimit, i cili përbëhet nga të paktën tre (3) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të titullarit të strukturës rajonale të punësimit.

7. Struktura e punësimit i komunikon OJF-së përgjigjen përfundimtare me vulë elektronike mbi pranimin apo refuzimin e kërkesës nëpërmjet portalit *"e-Albania"* në seksionin "Dokumentet e mia".

8. OJF-ja e përzgjedhur në bashkëpunim me strukturën vendore të punësimit, shërbimin social, bashkinë dhe komunitetin përgatisin listën e pjesëmarrësve në program. Palët e përcaktuara sipas pikës 8, të kreut II, të këtij vendimi, hartojnë planin individual të integrimit apo riintegrimit për secilin pjesëmarrës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune.

9. Komisioni i vlerësimit miraton, brenda tri (3) ditëve pune, dosjen përfundimtare të projektit.

10. OJF-të, të cilat përzgjidhen për zbatimin e programit, lidhin marrëveshje bashkëpunimi me strukturën rajonale të punësimit.

11. AKPA-ja dhe strukturat e saj të varësisë kanë detyrimin të monitorojnë zbatimin e programit, ndërsa OJF-të kanë detyrimin të raportojnë mbi zbatimin e tij.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit përcakton çdo vit prioritetet për zbatimin e këtij programi, sipas zonave gjeografike, sektorëve ekonomikë dhe nevojave të punëkërkuesve, dhe miraton planin e zbatimit të fondeve të nxitjes së punësimit pas propozimit nga AKPA-ja.

2. AKPA-ja përgatit raportin vjetor për zbatimin e programit brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse të ndihmës shtetërore.

3. AKPA-ja ruan të dhënat për programet 10 (dhjetë) vjet, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Vlerësimi i ndikimit të programit kryhet çdo katër (4) vjet nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, nëpërmjet ekspertëve ose organizatave me përvojë në këtë fushë.

5. Afati i zbatimit të programit është pesë (5) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Ngarkohet titullari i institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për hartimin e rregullores në funksion të programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegrimit social, brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit, në artikullin 603, në programin buxhetor "Tregu i punës".

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 402, datë 19.6.2024

PËR AUTORIZIMIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË TË NEGOCIOJË DREJTPËRDREJT ME SUBJEKTIN NDËRKOMBËTAR G37 CHAMBERS, PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË KONSULENCËS PËR ANALIZIMIN DHE VLERËSIMIN E TË DHËNAVE QË DUHET TË MBLIDHEN NGA MINISTRIA E DREJTËSISË, ME QËLLIM VLERËSIMIN E FUSHAVE TË REKOMANDIMEVE PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT DHE PËR HARTIMIN E METODOLOGJISË PËR MËNYRËN E VLERËSIMIT E TË NDJEKJES NË VAZHDIMËSI TË ZBATIMIT TË KËTYRE REKOMANDIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 16/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, 'Për prokurimin publik'", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e ministrit të Drejtësisë të negociojë drejtpërdrejt me subjektin ndërkombëtar G37 Chambers për ofrimin e shërbimit të konsulencës, për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave që duhet të mblidhen nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim vlerësimin e fushave të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit dhe për hartimin e metodologjisë për mënyrën e vlerësimit e të ndjekjes në vazhdimësi të zbatimit të këtyre rekomandimeve.

2. Negociimi të ketë në objekt:

a) identifikimin dhe analizimin e situatës aktuale të fushave kryesore që lidhen me luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e prokurorëve, si dhe garantimin e të drejtave e të lirive themelore të qytetarëve, në kuadër të rekomandimeve prioritare;

b) identifikimin dhe analizimin e situatës aktuale mbi politikën penale të ndjekur deri më tani, me fokus krimin e organizuar e antikorrupsionin dhe tendencat e kriminalitetit në vend, duke dhënë edhe rekomandime për vendimmarrjen e ardhshme për politikën penale;

c) evidentimin, marrjen dhe analizimin e të dhënave për vlerësimin e rekomandimeve të dhëna në luftën kundër kriminalitetit, si dhe për vlerësimin e politikës penale, që duhet të hartojë Ministria e Drejtësisë në përmbushje të detyrimit ligjor;

ç) identifikimin e kritereve të qarta dhe të matshme, të cilat do të shërbejnë si një pikënisje për daljen në konkluzione për rekomandimet që duhet të jepen, bazuar në vlerësimin e problematikave dhe gjetjeve mbi tendencat e kriminalitetit në vend, me fokus krimin e organizuar dhe antikorrupsionin në kategori të ndryshme të marrëdhënieve shoqërore që mbrohen nga Kodi Penal;

d) përgatitjen e formateve tip, platformave apo mjeteve/formave të tjera për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit mbi tendencën e kriminalitetit, si dhe mënyrën e zbatimit të rekomandimeve prioritare të cilat do të duhet të identifikohen nga këto të dhëna;

dh) identifikimin e fushave dhe çështjeve që duhet të shërbejnë si bazë në përgatitjen e rekomandimeve prioritare të ardhshme të Këshillit të Ministrave;

e) hartimin e metodologjisë për mënyrën e vlerësimit e të ndjekjes në vazhdimësi të zbatimit të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit dhe paraqitjen e saj për miratim pranë ministrit të Drejtësisë.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 403, datë 19.6.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "NIVELET E LEJUARA TË RADIOBËRTHAMAVE NË UJIN PËR KONSUM NJERËZOR PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT PUBLIK"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Nivelet e lejuara të radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor për mbrojtjen e shëndetit publik", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Me hyrjen në fuqi të rregullores "Nivelet e lejuara të radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor për mbrojtjen e shëndetit publik":

2.1. Në vendimin nr. 379, datë 25.5.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm", pjesa D "Radioaktiviteti", e shtojcës I, shfuqizohet;

2.2. Në vendimin nr. 957, datë 25.11.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për nivelet udhëzuese të përqendrimit të radonit në mjediset e brendshme dhe përqendrimet e radiobërthamave në mallra, me efekt mbrojtjen e publikut":

a) në nenin 1 hiqen fjalët "ujë të destinuar për konsum publik";

b) në nenin 2, shkronjat "gj," "i" dhe "ii" shfuqizohen;

c) nenet 6, 7, 8, 9 shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, organet

[1] *Ky vendim është përafruar plotësisht me direktivën 2013/51 KE e Këshillit Evropian, në datën 22 tetor 2013, "Kërkesat për mbrojtjen e shëndetit të publikut të gjerë në lidhje me substancat radioaktive në ujin e destinuar për konsum njerëzor", numri CELEX 32013L0051, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, serial L, nr. 296/12, datë 7.11.2013, OJ L 296 faqe 12–21.*

qendrore dhe vendore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe çdo institucion tjetër, publik ose privat, që kanë sistemin e tyre të furnizimit me ujë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2025.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE
NIVELET E LEJUARA TË RADIOBËRTHAMAVE NË UJIN PËR KONSUM NJERËZOR PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT PUBLIK

Neni 1
Objekti i rregullores

Kjo rregullore ka objekt:

a) Përcaktimin e kërkesave për mbrojtjen e shëndetit publik, në lidhje me radiobërthamat në ujin për konsum njerëzor;

b) Përcaktimin e vlerave të lejuara, frekuencave dhe metodave për monitorimin e radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor.

Neni 2
Përcaktimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ujë për konsum njerëzor" është uji që përfshin sa më poshtë:

a) ujërat e trajtuara ose të patrajtuara, të përcaktuara për qëllim pirje, gatimi, përgatitje të ushqimeve dhe për nevojat e higjienës, pavarësisht nga origjina e tyre dhe nga fakti nëse janë furnizuar prej një rrjeti shpërndarës, publik apo privat, prej cisternës, apo të ambalazhuara në shishe ose enë.

b) ujërat që përdoren në ndërmarrjet e prodhimit të ushqimeve për prodhimin, fabrikimin, përpunimin, ruajtjen apo tregtimin e prodhimeve ose lëndëve të përcaktuara për përdorim nga njerëzit, përveçse kur Agjencia e Kontrollit të Ushqimit, vlerëson që cilësia e ujit nuk mund të ndikojë në cilësinë e ushqimit në formën e tij përfundimtare.

2. "Substancë radioaktive" është çdo substancë që përmban një ose më shumë radiobërthama që aktiviteti ose përqendrimi i tyre nuk mund të shpërfillet për sa i përket mbrojtjes nga rrezatimi.

3. "Dozë treguese" ose "DT" është doza efektive kumulative për një vit gëlltitje, për të gjitha radiobërthamat, prania e të cilëve është konstatuar në furnizimin me ujë të destinuar për konsum njerëzor, me origjinë natyrale dhe artificiale, por duke përjashtuar tritiumin, kalium-40, radonin dhe radiobërthamat jetëshkurtra të zbërthimit të radonit.

4. "Vlerë e lejuar" është vlera kufi e radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor mbi bazën e të cilës Agjencia Kombëtare e Ushqimit vlerëson nëse prania e radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor, paraqet risk për shëndetin e publikut që kërkon ndërhyrje dhe, kur është e nevojshme, ndërmerr veprime korrigjuese për të përmirësuar cilësinë e ujit në një nivel që përputhet me kërkesat për mbrojtjen e shëndetit të publikut nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi.

Neni 3
Fusha e zbatimit dhe përjashtimet

1. Kjo rregullore zbatohet për ujin për konsum njerëzor.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet, për:

a) ujërat minerale natyrale të njohura si të tillë nga autoritetet kombëtare.

b) ujërat që janë produkte mjekësore.

c) ujin e destinuar ekskluzivisht për ato qëllime për të cilat autoritetet kompetente përkatëse vlerësojnë se cilësia e ujit nuk ka asnjë ndikim, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në shëndetin publik.

ç) ujin për konsum njerëzor nga një furnizim individual që siguron mesatarisht më pak se 10 m^3 në ditë, ose që shërben për më pak se 50 persona, përveç nëse uji ofrohet si pjesë e një aktiviteti tregtar ose publik.

3. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 2, shkronja "d", do të sigurojë që:

a) publiku i interesuar është i informuar për këtë dhe për ndonjë veprim që mund të ndërmerret për të mbrojtur shëndetin e publikut nga efektet e padëshiruara që vijnë nga çdo

ndotje e ujit për konsum njerëzor;

b) kur është evident një rrezik i mundshëm për shëndetin publik, që vjen nga cilësia e këtij uji, publikut të interesuar t'i jepen menjëherë këshillat e duhura.

Neni 4
Institucionet përgjegjëse

1. Furnizuesit e ujit për konsum njerëzor janë përgjegjës për monitorimin e tij në përputhje me këtë rregullore.

2. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar ose institucione të tjera të akredituara brenda ose jashtë vendit realizojnë matjet e radiobëthamave në ujin për konsum njerëzor.

3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit inspektojnë zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 5
Detyrimet e përgjithshme

1. Furnizuesit e ujit për konsum njerëzor marrin të gjitha masat e nevojshme për të hartuar dhe për të zbatuar një program të përshtatshëm monitorimi për ujin për konsum njerëzor, në përputhje me këtë rregullore.

2. Furnizuesit e ujit për konsum njerëzor në rast të mospërputhjes me vlerat e lejuara të përcaktuara në këtë rregullore njoftojnë strukturat rajonale të shëndetësisë, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor dhe sigurojnë, se:

a) do të vlerësojnë nëse kjo përbën rrezik për shëndetin e njerëzve që kërkon veprime të mëtejshme; dhe

b) do të ndërmarrin veprime korrigjuese, kur është e nevojshme, për të përmirësuar cilësinë e ujit në një nivel që përputhet me kërkesat për mbrojtjen e shëndetit të publikut nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimet.

3. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar ose institucione të tjera të akredituara brenda ose jashtë vendit lëshojnë një dokument zyrtar lidhur me matjet e kryera mbi nivelin e radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor.

4. Inspektorati Shëndetësor Shtetëror dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit inspektojnë dokumentacionin përkatës, që lidhet me matjen e parametrave dhe të niveleve të radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor, por mund të ndërmarrin dhe vlerësime të mëtejshme si ata e vlerësojnë.

Neni 6
Vlerat e lejuara dhe përputhshmëria

1. Vlerat e lejuara të zbatueshme për monitorimin e radiobërthamave në ujërat për konsum njerëzor duhet të jenë në përputhje me aneksin I.

2. Kur monitorimi i ujit për konsum njerëzor kryhet në përputhje me kërkesat e aneksit II, pika ku do të vlerësohet përputhshmëria do të jetë:

a) në rastin e ujit të furnizuar nga një rrjet shpërndarës, pika në të cilën uji del nga rubineti i konsumatorit;

b) në rastin e ujit të furnizuar nga një cisternë, pika në të cilën del nga cisterna;

c) në rastin e ujit të vendosur në shishe ose kontejnerë të destinuar për shitje, pika në të cilën uji vendoset në shishe ose kontejnerë.

ç) në rastin e ujit të përdorur në një ndërmarrje prodhimi ushqimor, pika ku uji përdoret në ndërmarrje.

3. Përcaktimi i pikave të përputhshmërisë në paragrafin 2, shkronja "a", bëhet pa paragjykim për zgjedhjen e një pike për marrjen e mostrave, e cila mund të jetë çdo pikë brenda zonës së furnizimit ose të punës, me kusht që vlera të mos ketë ndryshime përkeqësuese në përqendrim, ndërmjet pikës së marrjes së mostrës dhe pikës së përputhshmërisë.

Neni 7
Monitorimi dhe analiza

1. Furnizuesit e ujit për konsum njerëzor marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që monitorimi për radiobërthamat në ujë për konsum njerëzor bëhet në përputhje me strategjitë dhe frekuencat e monitorimit të përcaktuara në aneksin II, në mënyrë që të kontrollohet nëse vlerat e radiobërthamave janë në përputhje me vlerat e lejuara të përcaktuara në nenin 6, paragrafi 1.

2. Furnizuesit e ujit për konsum njerëzor marrin të gjitha masat e nevojshme që të sigurojnë që monitorimi të kryhet në mënyrë që

vlerat e matura janë përfaqësuese të cilësisë së ujit të konsumuar gjatë gjithë vitit. Për ujin për konsum njerëzor që futet në shishe ose kontejnerë të destinuar për shitje, kjo do të bëhet pa cenuar parimet e kontrollit dhe inspektimit nga ana e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për sigurinë e higjienës dhe parametrave të tjerë të sigurisë së ushqimit.

3. Monitorimi i DT-së do të kryhet për performancë analitike, dhe karakteristikat të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin III.

4. Çdo laborator në të cilin analizohen mostrat e ujit të për konsum njerëzor duhet të jetë i akreditуar dhe i nënshtrohet sistemit të kontrollit të cilësisë nga institucioni që e akrediton.

Neni 8
Veprimi korrigjuese dhe njoftimi i publikut

1. Çdo mospërputhje me vlerat e lejuara të përcaktuara në përputhje me nenin 6, paragrafi 1, ose nenin 7 paragrafi 1 hetohet menjëherë për të identifikuar shkakun.

2. Kur ka mospërputhje me vlerat e lejuara, furnizuesit njoftojnë njësitë vendore të kujdesit shëndetësor dhe Institutin e Shëndetit Publik, të cilët vlerësojnë nëse mospërputhja paraqet rrezik për shëndetin publik dhe përcakton masat për veprime të mëtejshme.

3. Në rast se një rrezik i tillë që referohet në paragrafin 2 ekziston, furnizuesi i ujit për konsum njerëzor do të:

a) ndërmarrë veprime korrigjuese për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e shëndetit të publikut nga rrezatimi; dhe

b) sigurojë që publiku është:

i. njoftuar për rrezikun dhe masat korrigjuese të ndërmarra; dhe

ii. këshilluar për çdo masë paraprake shtesë që mund të nevojiten për mbrojtjen e shëndetit të publikut në lidhje me substancat radioaktive.

ANEKSI I
VLERAT E LEJUARA PËR RADONIN, TRITIUMIN DHE DT TË UJIT PËR KONSUM NJERËZOR

Parametri	Vlera maksimale e lejuar	Njësia	Shënime
Radon	100	Bq/l	Shënimi 1
Tritium	100	Bq/l	Shënimi 2
DT	0.1	mSv	

Shënim 1:

a) Në raste të veçanta të justifikuara dhe në mënyrë të përkohshme, duhet vazhduar furnizimi me ujë në shkallë kombëtare apo rajonale dhe kur vlera e lejuar është më e lartë se 100 Bq/l por më e ulët se 1 000 Bq/l.

b) Veprimi përmirësues duhet ndërmarrë për arsye të mbrojtjes nga rrezatimet, ku përqendrimet e radonit kalojnë 1000 Bq/l

Shënim 2. Nivelet e larta të tritiumit mund të tregojnë praninë e radiobërthamave të tjera artificiale. Nëse përqendrimi i tritiumit tejkalon vlerën e lejuar duhet të bëhet një analizë e pranisë së radiobërthamave të tjera artificiale.

ANEKSI II
MONITORIMI I SUBSTANCAVE RADIOAKTIVE

1. Parimet e përgjithshme dhe frekuencat e monitorimit

Në rastin e radiobërthamave natyrale, ku rezultatet e mëparshme kanë treguar se përqendrimi i radiobërthamave është i qëndrueshëm, frekuenca e monitorimit, në përjashtim nga kërkesat minimale të mostrës të përcaktuara në pikën 6, mund të ndryshojë sipas përcaktimeve nga Instituti i Shëndetit Publik,

duke marrë parasysh rrezikun për shëndetin e publikut.

Nuk kërkohet monitorim i ujit për konsum njerëzor për radon, tritium ose për të vendosur DT, në rastet kur autoritetet kompetente, në bazë të sondazheve përfaqësuese, të dhënave të monitorimit ose informacioneve të tjera të besueshme gjykojnë që për një periudhë kohore që do të përcaktohet prej tyre, nivelet e radonit, tritiumit ose të DT-së së llogaritur do të mbeten nën vlerat e lejuara përkatëse të renditura në aneksin I. Në këtë rast, shpjegohen me shkrim arsyet për këtë vendim dhe arkivohet dokumentacioni i nevojshëm që mbështet vendimin, duke përfshirë gjetjet e ndonjë sondazhi, monitorimit ose hetimeve të kryera. Ky dokumentacion i vihet në dispozicion ministrisë përgjegjëse në fushën e shëndetit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Në këtë kontekst, nuk zbatohen dispozitat në lidhje me kërkesat minimale të marrjes së mostrave dhe analizës të përcaktuara në pikën 6 të këtij aneksi.

2. Radoni

Për të përcaktuar shkallën dhe natyrën e mundshme të ekspozimit ndaj radonit në ujin për konsum njerëzor me origjinë nga lloje të ndryshme të ujërave nëntokësore burime dhe puse në zona të ndryshme gjeologjike, ndërmerren sondazhe përfaqësuese. Vrojtimet do të organizohen në atë mënyrë që parametrat themelorë, dhe veçanërisht gjeologjia dhe hidrologjia e zonës, radioaktiviteti i shkëmbinjve ose tokës, dhe lloji i pusit, mund të identifikohen dhe të përdoren për të drejtuar veprime të mëtejshme në zonat me ekspozim të lartë. Monitorimi i përqendrimeve të radonit do të kryhet në rastet kur ka arsye për të besuar, në bazë të rezultateve të sondazheve përfaqësuese ose informacione të tjera të besueshme, se vlera e lejuar e përcaktuar në përputhje me nenin 6, paragrafi 1 të rregullores mund të tejkalohet.

3. Tritium

Monitorimi i tritiumit në ujin për konsum njerëzor kryhet kur një burim antropogjen i tritiumit ose radiobërthamave të tjera artificiale është i pranishëm brenda zonës së ujëmbledhësit dhe nuk mund të jetë i dukshëm në bazë të programeve apo hetimeve të tjera të mbikëqyrjes se niveli i tritiumit është nën vlerën e lejuar të renditur në aneksin I. Kur kërkohet monitorimi për tritium, ai duhet të kryhet në frekuencat e treguara në tabelën e paraqitur në pikën 6 të këtij aneksi. Nëse përqendrimi i tritiumit tejkalon vlerën e tij të lejuar, një hetim është i nevojshëm dhe për praninë e radiobërthamave të tjera artificiale.

4. Doza Treguese (DT)

Monitorimi i ujit për konsum njerëzor për DT do të kryhet kur një burim artificial ose radioaktiviteti natyror i larte është i pranishëm dhe ai nuk mund të duket në bazë të monitorimeve të tjera përfaqësuese, programe ose hetime të tjera që niveli i DT-së është nën vlerën e lejuar të renditur në aneksin I. Aty ku kërkohet monitorimi për nivelet artificiale të radiobërthamave, ai duhet të kryhet në frekuencën e treguar në tabelë të paraqitur në pikën 6 të këtij aneksi. Kur kërkohet monitorim për nivelet natyrore të radiobërthamave, Instituti i Shëndetit Publik, në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, përcakton frekuencën e monitorimit të radioaktivitetit bruto alfa, aktivitetit bruto beta ose radiobërthamave natyrore individuale, në varësi të strategjisë së shqyrtimit të miratuar prej saj (sipas aneksit III). Frekuenca e monitorimit mund të ndryshojë nga një matje e vetme kontrolli në frekuencat e treguara në tabelën e paraqitur në pikën 6 të këtij aneksi. Aty ku vetëm kërkohet një kontroll i vetëm për radioaktivitet natyror, duhet të kërkohet të paktën një rikontroll kur ndodh ndonjë ndryshim në lidhje për furnizimin që mund të ndikojë në përqendrimet e radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor.

5. Trajtimi i ujit

Aty ku është bërë trajtimi për të ulur nivelin e radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor, monitorimi do të kryhet në frekuencat e treguara në tabelën e paraqitur në pikën 6 për të siguruar vazhdimësinë dhe efikasitetin e atij trajtimi.

6. Frekuenca minimale e marrjes së mostrave dhe analizës

Frekuenca minimale e marrjes së mostrave dhe të analizave për monitorimin e ujit të furnizuar për konsum njerëzor nga një rrjet shpërndarës ose nga një cisternë ose që përdoret në një ndërmarrje prodhimi ushqimor do të jetë, siç përcaktohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1

Frekuencat minimale të marrjes së mostrave dhe analizave për monitorimin e ujit për konsum njerëzor të furnizuar nga një rrjet shpërndarjeje ose nga një cisternë ose që përdoret në një ndërmarrje prodhimi ushqimor

Vëllimi i ujit që shpërndahet ose prodhohet çdo ditë brenda një furnizimi zonë (shënimet 1 dhe 2) në m^3	Numri i mostrave në vit (shënimet 3 dhe 4)
vëllimi≤ 100	(Shënimi 5)
100 < vëllimi ≤ 1 000	1
1 000 < vëllimi ≤ 10 000	1 + 1 për çdo 3 300 m^3/d dhe pjesë të vëllimit të përgjithshëm
10 000 < vëllimi ≤ 100 000	3 + 1 për çdo 10 000 m^3/d nga një pjesë të vëllimit të përgjithshëm
vëllimi > 100 000	10 + 1 për çdo 25 000 m^3/d nga një pjesë të vëllimit të përgjithshëm

Shënim 1. Një zonë furnizimi është një zonë e përcaktuar gjeografikisht brenda së cilës uji i destinuar për konsum njerëzor vjen nga një ose më shumë burime dhe brenda të cilave cilësia e ujit mund të konsiderohet përafërsisht uniforme.

Shënim 2. Vëllimet llogariten si mesatare të marra gjatë një viti kalendarik. Për të përcaktuar frekuencën minimale, në vend të vëllimit të ujit mund të përdoret numri i banorëve në zonën e furnizimit, duke supozuar një konsum të ujit prej 200 l/ditë/frymë

Shënim 3. Për aq sa është e mundur, numri i mostrave duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë në kohë dhe vendndodhje.

Shënim 4. Në rast të furnizimit me ndërprerje afatshkurtër, frekuenca e monitorimit të ujit të shpërndarë nga cisternat do të vendoset nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Shënim 5. Frekuenca do të vendoset nga Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit përcakton frekuencat e marrjes së mostrave për ujin për konsum njerëzor të vendosur në shishe ose kontejnerë të destinuar për shitje. Duke bërë këtë, Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit mund të marrin në konsideratë vëllimin e ujit të prodhuar.

7. Mesatarja

Kur një vlerë e lejuar tejkalohet në një mostër të caktuar, Instituti i Shëndetit Publik përcakton shtrirjen e marrjes së mostrës të nevojshme për të siguruar që vlerat e matura janë përfaqësuese të një përqendrimi mesatar të aktivitetit për një vit të plotë.

ANEKSI III

MONITORIMI PËR DOZËN TREGUESE DHE KARAKTERISTIKAT E PERFORMANCËS ANALITIKE

1. Monitorimi për respektimin e DT

Për të treguar praninë e radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor mund të përdoren strategji të ndryshme të besueshme të vlerësimit. Këto strategji mund të përfshijnë ekzaminimin e radiobërthamave të caktuara ose ekzaminimin për një radiobërthamë, ose aktivitetin bruto alfa ose ekzaminimin e aktivitetit bruto beta.

a) ekzaminimi për radiobërthama të caktuara ose ekzaminimi për një radiobërthamë individuale

Nëse një nga përqendrimet e aktivitetit kalon 20% të vlerës përkatëse të derivuar ose përqendrimi i tritiumit tejkalon vlerën e tij të lejuar të renditur në aneksin I, kërkohet një analizë shtesë e radiobërthamave. Radiobërthamat që do të maten, përcaktohen nga institucione gjeologjike ose kërkimore, duke marrë parasysh mundësinë e prezencës në lidhje me burimet e mundshme me aktivitet radiologjik.

b) strategjitë e vlerësimit për aktivitetin bruto alfa dhe aktivitetin bruto beta.

Do të përdoret si strategji vlerësimi nëpërmjet kontrollit për aktivitetin bruto alfa dhe aktivitetin bruto beta për të monitoruar vlera e treguesit numerikë për DT.

Për këtë qëllim do të përcaktohen nivelet e vlerësimit të aktivitetit bruto alfa ose bruto beta. Niveli i rekomanduar i vlerësimit për aktivitetin bruto alfa është 0,1 Bq/l. Niveli i rekomanduar i vlerësimit për aktivitetin bruto beta është 1,0 Bq/l.

Np-237	2,14 10^6 a	0,005	2,0 10^{-6}	5,0 10^{-4}	2,1 10^{-7}	1,4 10^{-7}	1,1 10^{-7}	1,1 10^{-7}	1,1 10^{-7}
Np-238	2,12 d	0,005	9,5 10^{-9}	5,0 10^{-4}	6,2 10^{-9}	3,2 10^{-9}	1,9 10^{-9}	1,1 10^{-9}	9,1 10^{-10}
Np-239	2,36 d	0,005	8,9 10^{-9}	5,0 10^{-4}	5,7 10^{-9}	2,9 10^{-9}	1,7 10^{-9}	1,0 10^{-9}	8,0 10^{-10}
Np-240	1,08 h	0,005	8,7 10^{-10}	5,0 10^{-4}	5,2 10^{-10}	2,6 10^{-10}	1,6 10^{-10}	1,0 10^{-10}	8,2 10^{-11}

Radiobërthamë	Perioda e Gjysmëzbërthimit	Mosha ≤ 1 a		Mosha	1—2 a	2—7 a	7—12 a	12—17 a	> 17 a
		f_1 për g ≤ 1 a	h(g)	f_1 për g > 1 a	h(g)	h(g)	h(g)	h(g)	h(g)
Plutonium									
Pu-234	8,80 h	0,005	$2{,}1\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$1{,}1\ 10^{-9}$	$5{,}5\ 10^{-10}$	$3{,}3\ 10^{-10}$	$2{,}0\ 10^{-10}$	$1{,}6\ 10^{-10}$
Pu-235	0,422 h	0,005	$2{,}2\ 10^{-11}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$1{,}3\ 10^{-11}$	$6{,}5\ 10^{-12}$	$3{,}9\ 10^{-12}$	$2{,}7\ 10^{-12}$	$2{,}1\ 10^{-12}$
Pu-236	2,85 a	0,005	$2{,}1\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$2{,}2\ 10^{-7}$	$1{,}4\ 10^{-7}$	$1{,}0\ 10^{-7}$	$8{,}5\ 10^{-8}$	$8{,}7\ 10^{-8}$
Pu-237	45,3 d	0,005	$1{,}1\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$6{,}9\ 10^{-10}$	$3{,}6\ 10^{-10}$	$2{,}2\ 10^{-10}$	$1{,}3\ 10^{-10}$	$1{,}0\ 10^{-10}$
Pu-238	87,7 a	0,005	$4{,}0\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$4{,}0\ 10^{-7}$	$3{,}1\ 10^{-7}$	$2{,}4\ 10^{-7}$	$2{,}2\ 10^{-7}$	$2{,}3\ 10^{-7}$
Pu-239	$2{,}41\ 10^{4}$ a	0,005	$4{,}2\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$4{,}2\ 10^{-7}$	$3{,}3\ 10^{-7}$	$2{,}7\ 10^{-7}$	$2{,}4\ 10^{-7}$	$2{,}5\ 10^{-7}$
Pu-240	$6{,}54\ 10^{3}$ a	0,005	$4{,}2\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$4{,}2\ 10^{-7}$	$3{,}3\ 10^{-7}$	$2{,}7\ 10^{-7}$	$2{,}4\ 10^{-7}$	$2{,}5\ 10^{-7}$
Pu-241	14,4 a	0,005	$5{,}6\ 10^{-8}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$5{,}7\ 10^{-9}$	$5{,}5\ 10^{-9}$	$5{,}1\ 10^{-9}$	$4{,}8\ 10^{-9}$	$4{,}8\ 10^{-9}$
Pu-242	$3{,}76\ 10^{5}$ a	0,005	$4{,}0\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$4{,}0\ 10^{-7}$	$3{,}2\ 10^{-7}$	$2{,}6\ 10^{-7}$	$2{,}3\ 10^{-7}$	$2{,}4\ 10^{-7}$
Pu-243	4,95 h	0,005	$1{,}0\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$6{,}2\ 10^{-10}$	$3{,}1\ 10^{-10}$	$1{,}8\ 10^{-10}$	$1{,}1\ 10^{-10}$	$8{,}5\ 10^{-11}$
Pu-244	$8{,}26\ 10^{7}$ a	0,005	$4{,}0\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$4{,}1\ 10^{-7}$	$3{,}2\ 10^{-7}$	$2{,}6\ 10^{-7}$	$2{,}3\ 10^{-7}$	$2{,}4\ 10^{-7}$
Pu-245	10,5 h	0,005	$8{,}0\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$5{,}1\ 10^{-9}$	$2{,}6\ 10^{-9}$	$1{,}5\ 10^{-9}$	$8{,}9\ 10^{-10}$	$7{,}2\ 10^{-10}$
Pu-246	10,9 d	0,005	$3{,}6\ 10^{-8}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$2{,}3\ 10^{-8}$	$1{,}2\ 10^{-8}$	$7{,}1\ 10^{-9}$	$4{,}1\ 10^{-9}$	$3{,}3\ 10^{-9}$
Americium									
Am-237	1,22 h	0,005	$1{,}7\ 10^{-10}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$1{,}0\ 10^{-10}$	$5{,}5\ 10^{-11}$	$3{,}3\ 10^{-11}$	$2{,}2\ 10^{-11}$	$1{,}8\ 10^{-11}$
Am-238	1,63 h	0,005	$2{,}5\ 10^{-10}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$1{,}6\ 10^{-10}$	$9{,}1\ 10^{-11}$	$5{,}9\ 10^{-11}$	$4{,}0\ 10^{-11}$	$3{,}2\ 10^{-11}$
Am-239	11,9 h	0,005	$2{,}6\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$1{,}7\ 10^{-9}$	$8{,}4\ 10^{-10}$	$5{,}1\ 10^{-10}$	$3{,}0\ 10^{-10}$	$2{,}4\ 10^{-10}$
Am-240	2,12 d	0,005	$4{,}7\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}3\ 10^{-9}$	$1{,}8\ 10^{-9}$	$1{,}2\ 10^{-9}$	$7{,}3\ 10^{-10}$	$5{,}8\ 10^{-10}$
Am-241	$4{,}32\ 10^{2}$ a	0,005	$3{,}7\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}7\ 10^{-7}$	$2{,}7\ 10^{-7}$	$2{,}2\ 10^{-7}$	$2{,}0\ 10^{-7}$	$2{,}0\ 10^{-7}$
Am-242	16,0 h	0,005	$5{,}0\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$2{,}2\ 10^{-9}$	$1{,}1\ 10^{-9}$	$6{,}4\ 10^{-10}$	$3{,}7\ 10^{-10}$	$3{,}0\ 10^{-10}$
Am-242m	$1{,}52\ 10^{2}$ a	0,005	$3{,}1\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}0\ 10^{-7}$	$2{,}3\ 10^{-7}$	$2{,}0\ 10^{-7}$	$1{,}9\ 10^{-7}$	$1{,}9\ 10^{-7}$
Am-243	$7{,}38\ 10^{3}$ a	0,005	$3{,}6\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}7\ 10^{-7}$	$2{,}7\ 10^{-7}$	$2{,}2\ 10^{-7}$	$2{,}0\ 10^{-7}$	$2{,}0\ 10^{-7}$
Am-244	10,1 h	0,005	$4{,}9\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}1\ 10^{-9}$	$1{,}6\ 10^{-9}$	$9{,}6\ 10^{-10}$	$5{,}8\ 10^{-10}$	$4{,}6\ 10^{-10}$
Am-244m	0,433 h	0,005	$3{,}7\ 10^{-10}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$2{,}0\ 10^{-10}$	$9{,}6\ 10^{-11}$	$5{,}5\ 10^{-11}$	$3{,}7\ 10^{-11}$	$2{,}9\ 10^{-11}$
Am-245	2,05 h	0,005	$6{,}8\ 10^{-10}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$4{,}5\ 10^{-10}$	$2{,}2\ 10^{-10}$	$1{,}3\ 10^{-10}$	$7{,}9\ 10^{-11}$	$6{,}2\ 10^{-11}$
Am-246	0,650 h	0,005	$6{,}7\ 10^{-10}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}8\ 10^{-10}$	$1{,}9\ 10^{-10}$	$1{,}1\ 10^{-10}$	$7{,}3\ 10^{-11}$	$5{,}8\ 10^{-11}$
Am-246m	0,417 h	0,005	$3{,}9\ 10^{-10}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$2{,}2\ 10^{-10}$	$1{,}1\ 10^{-10}$	$6{,}4\ 10^{-11}$	$4{,}4\ 10^{-11}$	$3{,}4\ 10^{-11}$
Curium									
Cm-238	2,40 h	0,005	$7{,}8\ 10^{-10}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$4{,}9\ 10^{-10}$	$2{,}6\ 10^{-10}$	$1{,}6\ 10^{-10}$	$1{,}0\ 10^{-10}$	$8{,}0\ 10^{-11}$
Cm-240	27,0 d	0,005	$2{,}2\ 10^{-7}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$4{,}8\ 10^{-8}$	$2{,}5\ 10^{-8}$	$1{,}5\ 10^{-8}$	$9{,}2\ 10^{-9}$	$7{,}6\ 10^{-9}$
Cm-241	32,8 d	0,005	$1{,}1\ 10^{-8}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$5{,}7\ 10^{-9}$	$3{,}0\ 10^{-9}$	$1{,}9\ 10^{-9}$	$1{,}1\ 10^{-9}$	$9{,}1\ 10^{-10}$
Cm-242	163 d	0,005	$5{,}9\ 10^{-7}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$7{,}6\ 10^{-8}$	$3{,}9\ 10^{-8}$	$2{,}4\ 10^{-8}$	$1{,}5\ 10^{-8}$	$1{,}2\ 10^{-8}$
Cm-243	28,5 a	0,005	$3{,}2\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}3\ 10^{-7}$	$2{,}2\ 10^{-7}$	$1{,}6\ 10^{-7}$	$1{,}4\ 10^{-7}$	$1{,}5\ 10^{-7}$
Cm-244	18,1 a	0,005	$2{,}9\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$2{,}9\ 10^{-7}$	$1{,}9\ 10^{-7}$	$1{,}4\ 10^{-7}$	$1{,}2\ 10^{-7}$	$1{,}2\ 10^{-7}$
Cm-245	$8{,}50\ 10^{3}$ a	0,005	$3{,}7\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}7\ 10^{-7}$	$2{,}8\ 10^{-7}$	$2{,}3\ 10^{-7}$	$2{,}1\ 10^{-7}$	$2{,}1\ 10^{-7}$
Cm-246	$4{,}73\ 10^{3}$ a	0,005	$3{,}7\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}7\ 10^{-7}$	$2{,}8\ 10^{-7}$	$2{,}2\ 10^{-7}$	$2{,}1\ 10^{-7}$	$2{,}1\ 10^{-7}$
Cm-247	$1{,}56\ 10^{7}$ a	0,005	$3{,}4\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}5\ 10^{-7}$	$2{,}6\ 10^{-7}$	$2{,}1\ 10^{-7}$	$1{,}9\ 10^{-7}$	$1{,}9\ 10^{-7}$
Cm-248	$3{,}39\ 10^{5}$ a	0,005	$1{,}4\ 10^{-5}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$1{,}4\ 10^{-6}$	$1{,}0\ 10^{-6}$	$8{,}4\ 10^{-7}$	$7{,}7\ 10^{-7}$	$7{,}7\ 10^{-7}$
Cm-249	1,07 h	0,005	$3{,}9\ 10^{-10}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$2{,}2\ 10^{-10}$	$1{,}1\ 10^{-10}$	$6{,}1\ 10^{-11}$	$4{,}0\ 10^{-11}$	$3{,}1\ 10^{-11}$
Cm-250	$6{,}90\ 10^{3}$ a	0,005	$7{,}8\ 10^{-5}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$8{,}2\ 10^{-6}$	$6{,}0\ 10^{-6}$	$4{,}9\ 10^{-6}$	$4{,}4\ 10^{-6}$	$4{,}4\ 10^{-6}$
Berkelium									
Bk-245	4,94 d	0,005	$6{,}1\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$3{,}9\ 10^{-9}$	$2{,}0\ 10^{-9}$	$1{,}2\ 10^{-9}$	$7{,}2\ 10^{-10}$	$5{,}7\ 10^{-10}$
Bk-246	1,83 d	0,005	$3{,}7\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$2{,}6\ 10^{-9}$	$1{,}4\ 10^{-9}$	$9{,}4\ 10^{-10}$	$6{,}0\ 10^{-10}$	$4{,}8\ 10^{-10}$
Bk-247	$1{,}38\ 10^{3}$ a	0,005	$8{,}9\ 10^{-6}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$8{,}6\ 10^{-7}$	$6{,}3\ 10^{-7}$	$4{,}6\ 10^{-7}$	$3{,}8\ 10^{-7}$	$3{,}5\ 10^{-7}$
Bk-249	320 d	0,005	$2{,}2\ 10^{-8}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$2{,}9\ 10^{-9}$	$1{,}9\ 10^{-9}$	$1{,}4\ 10^{-9}$	$1{,}1\ 10^{-9}$	$9{,}7\ 10^{-10}$
Bk-250	3,22 h	0,005	$1{,}5\ 10^{-9}$	$5{,}0\ 10^{-4}$	$8{,}5\ 10^{-10}$	$4{,}4\ 10^{-10}$	$2{,}7\ 10^{-10}$	$1{,}7\ 10^{-10}$	$1{,}4\ 10^{-10}$

Radiobërthamë	Perioda e Gjysmëzbërthimit	Mosha ≤ 1 a		Mosha	1—2 a	2—7 a	7—12 a	12—17 a	> 17 a
		f_1 për g ≤ 1 a	h(g)	f_1 për g > 1 a	h(g)	h(g)	h(g)	h(g)	h(g)
Californium									
Cf-244	0,323 h	0,005	$9,8\ 10^{-10}$	$5,0\ 10^{-4}$	$4,8\ 10^{-10}$	$2,4\ 10^{-10}$	$1,3\ 10^{-10}$	$8,9\ 10^{-11}$	$7,0\ 10^{-11}$
Cf-246	1,49 d	0,005	$5,0\ 10^{-8}$	$5,0\ 10^{-4}$	$2,4\ 10^{-8}$	$1,2\ 10^{-8}$	$7,3\ 10^{-9}$	$4,1\ 10^{-9}$	$3,3\ 10^{-9}$
Cf-248	334 d	0,005	$1,5\ 10^{-6}$	$5,0\ 10^{-4}$	$1,6\ 10^{-7}$	$9,9\ 10^{-8}$	$6,0\ 10^{-8}$	$3,3\ 10^{-8}$	$2,8\ 10^{-8}$
Cf-249	$3,50\ 10^{2}$ a	0,005	$9,0\ 10^{-6}$	$5,0\ 10^{-4}$	$8,7\ 10^{-7}$	$6,4\ 10^{-7}$	$4,7\ 10^{-7}$	$3,8\ 10^{-7}$	$3,5\ 10^{-7}$
Cf-250	13,1 a	0,005	$5,7\ 10^{-6}$	$5,0\ 10^{-4}$	$5,5\ 10^{-7}$	$3,7\ 10^{-7}$	$2,3\ 10^{-7}$	$1,7\ 10^{-7}$	$1,6\ 10^{-7}$
Cf-251	$8,98\ 10^{2}$ a	0,005	$9,1\ 10^{-6}$	$5,0\ 10^{-4}$	$8,8\ 10^{-7}$	$6,5\ 10^{-7}$	$4,7\ 10^{-7}$	$3,9\ 10^{-7}$	$3,6\ 10^{-7}$
Cf-252	2,64 a	0,005	$5,0\ 10^{-6}$	$5,0\ 10^{-4}$	$5,1\ 10^{-7}$	$3,2\ 10^{-7}$	$1,9\ 10^{-7}$	$1,0\ 10^{-7}$	$9,0\ 10^{-8}$
Cf-253	17,8 d	0,005	$1,0\ 10^{-7}$	$5,0\ 10^{-4}$	$1,1\ 10^{-8}$	$6,0\ 10^{-9}$	$3,7\ 10^{-9}$	$1,8\ 10^{-9}$	$1,4\ 10^{-9}$
Cf-254	60,5 d	0,005	$1,1\ 10^{-5}$	$5,0\ 10^{-4}$	$2,6\ 10^{-6}$	$1,4\ 10^{-6}$	$8,4\ 10^{-7}$	$5,0\ 10^{-7}$	$4,0\ 10^{-7}$
Einsteinium									
Es-250	2,10 h	0,005	$2,3\ 10^{-10}$	$5,0\ 10^{-4}$	$9,9\ 10^{-11}$	$5,7\ 10^{-11}$	$3,7\ 10^{-11}$	$2,6\ 10^{-11}$	$2,1\ 10^{-11}$
Es-251	1,38 d	0,005	$1,9\ 10^{-9}$	$5,0\ 10^{-4}$	$1,2\ 10^{-9}$	$6,1\ 10^{-10}$	$3,7\ 10^{-10}$	$2,2\ 10^{-10}$	$1,7\ 10^{-10}$
Es-253	20,5 d	0,005	$1,7\ 10^{-7}$	$5,0\ 10^{-4}$	$4,5\ 10^{-8}$	$2,3\ 10^{-8}$	$1,4\ 10^{-8}$	$7,6\ 10^{-9}$	$6,1\ 10^{-9}$
Es-254	276 d	0,005	$1,4\ 10^{-6}$	$5,0\ 10^{-4}$	$1,6\ 10^{-7}$	$9,8\ 10^{-8}$	$6,0\ 10^{-8}$	$3,3\ 10^{-8}$	$2,8\ 10^{-8}$
Es-254m	1,64 d	0,005	$5,7\ 10^{-8}$	$5,0\ 10^{-4}$	$3,0\ 10^{-8}$	$1,5\ 10^{-8}$	$9,1\ 10^{-9}$	$5,2\ 10^{-9}$	$4,2\ 10^{-9}$
Fermium									
Fm-252	22,7 h	0,005	$3,8\ 10^{-8}$	$5,0\ 10^{-4}$	$2,0\ 10^{-8}$	$9,9\ 10^{-9}$	$5,9\ 10^{-9}$	$3,3\ 10^{-9}$	$2,7\ 10^{-9}$
Fm-253	3,00 d	0,005	$2,5\ 10^{-8}$	$5,0\ 10^{-4}$	$6,7\ 10^{-9}$	$3,4\ 10^{-9}$	$2,1\ 10^{-9}$	$1,1\ 10^{-9}$	$9,1\ 10^{-10}$
Fm-254	3,24 h	0,005	$5,6\ 10^{-9}$	$5,0\ 10^{-4}$	$3,2\ 10^{-9}$	$1,6\ 10^{-9}$	$9,3\ 10^{-10}$	$5,6\ 10^{-10}$	$4,4\ 10^{-10}$
Fm-255	20,1 h	0,005	$3,3\ 10^{-8}$	$5,0\ 10^{-4}$	$1,9\ 10^{-8}$	$9,5\ 10^{-9}$	$5,6\ 10^{-9}$	$3,2\ 10^{-9}$	$2,5\ 10^{-9}$
Fm-257	101 d	0,005	$9,8\ 10^{-7}$	$5,0\ 10^{-4}$	$1,1\ 10^{-7}$	$6,5\ 10^{-8}$	$4,0\ 10^{-8}$	$1,9\ 10^{-8}$	$1,5\ 10^{-8}$
Mendelevium									
Md-257	5,20 h	0,005	$3,1\ 10^{-9}$	$5,0\ 10^{-4}$	$8,8\ 10^{-10}$	$4,5\ 10^{-10}$	$2,7\ 10^{-10}$	$1,5\ 10^{-10}$	$1,2\ 10^{-10}$
Md-258	55,0 d	0,005	$6,3\ 10^{-7}$	$5,0\ 10^{-4}$	$8,9\ 10^{-8}$	$5,0\ 10^{-8}$	$3,0\ 10^{-8}$	$1,6\ 10^{-8}$	$1,3\ 10^{-8}$

VENDIM
Nr. 404, datë 19.6.2024

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME, PËR MARRJEN E MASAVE PARANDALUESE, PËR PËRHAPJEN E ZJARREVE NË TOKA BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 16/1, të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Djegia e masës bimore, pjesëve të tyre dhe mbetjeve bimore kryhet në periudhën nga 30 nëntori deri në 1 prill, në përputhje me ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, dhe me përcaktimet e këtij vendimi.

2. Djegia kryhet në një zonë të kufizuar që nuk tejkalon 5% të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës, ku prodhohet masa bimore që asgjësohet me djegie.

3. Subjektet, pronarë ose posedues, paraqesin kërkesën në njësinë e vetëqeverisjes vendore për kryerjen e procesit të djegies, e cila përmban:

a) të dhënat kadastrale të parcelës/ngastrës, në të cilën do të ndizet zjarri;

b) sipërfaqen e tokës brenda parcelës ku do të kryhet procesi i djegies;

c) shkaqet e asgjësimit me djegie;

ç) argumentimin agronomik të shkaqeve;

d) llojin e bimësisë që do të digjet;

dh) datën dhe orën e ndezjes së zjarrit;

e) masat mbrojtëse të marra prej tij për mbrojtjen nga zjarri;

ë) pëlqimin/miratimin me shkrim nga pronarët ose poseduesit kufitarë të tokës bujqësore, të vërtetuar nga kryetari i fshatit.

4. Njësitë e vetëqeverisje vendore, brenda 5 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës:

a) bëjnë verifikimin në terren të ngastrës në të cilën do të ndizet zjarri;

b) njoftojnë strukturën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

c) përcaktojnë specialistin e zyrës së mbrojtjes së tokës që do të mbikëqyrë kryerjen e ndezjes së zjarrit.

5. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin kryen verifikimin e përmbushjes së kushteve sipas pikës 5, të nenit 16/1, të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, dhe, brenda 5 ditëve pune nga data e njoftimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, miraton kryerjen e procesit dhe përcakton masa parandaluese për djegien e kontrolluar, sipas formatit të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

6. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda 5 ditëve pune nga dhënia e lejes nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, lëshojnë lejen e ndezjes së zjarrit, ku specifikohen:

a) subjekti pronar ose posedues që kryen procesin e djegies;

b) vendndodhja e sipërfaqes ku realizohet djegia, si dhe data dhe orari i procesit të djegies;

c) pëlqimi me shkrim prej pronarëve ose përdoruesve të ngastrave në kufi me ngastrën ku do të kryhet djegia;

ç) masat e detyrueshme që zbatohen nga subjekti pronar ose posedues i tokës, përgjegjës për procesin e djegies dhe organet e vetëqeverisjes vendore për mbrojtjen nga zjarri.

7. Djegia e mbetjeve bimore nuk kryhet nëse materialet janë të ndotura, kanë substanca të rrezikshme, konservues, regjës, veshje të tjera artificiale, lëndë druri, pemë, mbetje nga krasitja e pemëve, gjethe, ashkla ose mbetje të tjera të ngjashme, të krijuara nga kultivimi dhe punimet në parcelë/ngastër.

8. Ndalohet djegia e masës bimore, pjesëve të tyre apo mbetjeve bimore në tokat bujqësore të llojit arë, vresht, pemëtore dhe djegia në kullota, shkurre dhe ferra pa miratimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Përjashtimisht, asgjësimi me djegie realizohet bazuar në urdhrin e autoriteteve kompetente për shkaqe që lidhen me shëndetin e bimëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve, mjedisit dhe shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

9. Djegia e masës bimore në tokat torfike është e ndaluar.

10. Në procesin e djegies nuk përfshihen mbetje që nuk janë të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 405, datë 19.6.2024

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË "INVESTITOR NË STRUKTURË AKOMODUESE ME 5 YJE, STATUS SPECIAL" APLIKUESIT "*GRAND HOTEL* BORSH" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33/1, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special" aplikuesit "*Grand Hotel* Borsh" sh.p.k.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për turizmin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 406, datë 19.6.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 494, DATË 24.8.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS, SHENJAVE DALLUESE DHE MODELIT TË DOKUMENTIT INDIVIDUAL TË IDENTIFIKIMIT, NGJYRËS, SHENJAVE DHE PËRDORIMIT TË MJETEVE LËVIZËSE TË POLICISË BASHKIAKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 46, pika 6, dhe 47, pika 2, të ligjit nr. 89/2022, "Për Policinë Bashkiake", me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

1. Lidhja nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 494, datë 24.8.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake", zëvendësohet me lidhjen që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA NR. 1
KREU I
PARAQITJA, FORMA, SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE PËRSHKRIMI I UNIFORMËS SË POLICISË BASHKIAKE

PARAQITJA DHE FORMA E UNIFORMAVE TË POLICISË BASHKIAKE
Normat e furnizimit miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak.
Uniforma do të jetë e ndarë në 3 lloje:
1. Uniforma shërbimi dimërore;
2. Uniforma shërbimi verore;
3. Uniforma ceremoniale.

1. UNIFORMA SHËRBIMI DIMËRORE

Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapelë, këpucë).

Xhaketa e kostumit të uniformës do të jetë **blu e errët,** me spaleta për vendosjen e shenjave të supit dhe katër kopsa. Ka katër xhepa me kapak (dy xhepa të vegjël në pjesën e gjoksit dhe dy xhepa të mëdhenj të poshtëm). Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë. Te jaka vendoset elementi kryesor i stemës së Bashkisë. Xhaketa e uniformës për femra është e njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra, me kopsat në anën e majtë.

Pantallonat, njëlloj me xhaketën ngjyrë **blu e errët**. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonalë dhe me një xhep të pasmë. Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pantallonat për femra kanë konstruksion të njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra.

Pamja përpara Pamja prapa

Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë e kaltër. Këmisha në pjesën e supeve ka 2 spaleta për montimin e shenjave të supit. Mbyllja e këmishës bëhet me 7 kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit. Këmisha për femra është e njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.

Kravata blu e errët, me një shirit të hollë të kaltër dhe gjerësi maksimumi 7–8 cm.

Kapelë blu e errët, me stemën e Bashkisë në qendër, shoqëruar me shirit të bardhë përpara dhe me kopsa si të xhaketës. Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë. Ky model do të jetë për punonjësit meshkuj.

Pamja anash

Pamja përpara

Pamja anash

Kapelë blu e errët, me stemën e Bashkisë në qendër, shoqëruar me shirit të bardhë përpara. Ky model do të jetë për punonjëset femra.

Pamja anash

Pamja përpara

Pamja anash

Këpucë uniforme ngjyrë e zezë dhe me lidhëse.

Pulovër blu e errët golf me zinxhir. Ka përforcime doku në bërryla dhe supe, me spaleta doku. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit.

Xhup blu i errët në pjesën poshtë, shoqëruar me shirit të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Pjesa e sipërme është ngjyrë e kaltër. Mëngët janë ngjyrë blu e errët së bashku me jakën. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë dhe në krahun e djathtë, poshtë shiritit shenja e gjoksit. Në pjesën e pasme vendoset mbishkrimi: "POLICIA BASHKIAKE".

Pamja përpara

Pamja prapa

Xhuboks blu i errët në pjesën poshtë, shoqëruar me shirit të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Pjesa e sipërme është ngjyrë e kaltër. Mëngët janë një pjesë ngjyrë blu e errët dhe pjesa tjetër e kaltër. Jaka është blu e errët. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë dhe në krahun e djathtë, poshtë shiritit shenja e gjoksit. Në pjesën e pasme vendoset mbishkrimi "POLICIA BASHKIAKE".

Pamja përpara

Pamja prapa

Këpucë me qafa, ngjyrë e zezë, me lidhëse. Këto shërbejnë edhe për stërvitje.

Bluzë e brendshme dimri e trikotuar, ngjyrë e zezë, me jakë rrethore. Në pjesën përpara në anën e majtë sipër, vendoset stema e Bashkisë dhe në pjesën prapa do të ketë mbishkrimin: "POLICIA BASHKIAKE". Ky model shërben edhe për stërvitje.

Pamja përpara

Pamja prapa

Bluzë me mëngë të gjata ngjyrë blu e errët, e trikotuar, e hapur në mes dhe mbyllet përpara me tri kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë, ndërsa përpara në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit. Bluza për femra është e njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.

Pelerina e shiut është me **ngjyrë të zezë**. Pelerina në pjesën përpara në anën e majtë sipër ka stemën e Bashkisë dhe në pjesën prapa do të ketë mbishkrimin: "POLICIA BASHKIAKE". Pelerina e shiut duhet të ketë prerje pardesyje, e padepërtueshme nga uji, era dhe me kapuç të lëvizshëm.

Pamja përpara

Pamja prapa

Doreza ngjyrë të zezë.

2. UNIFORMA SHËRBIMI VERORE

Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapelë, këpucë).

Pantallona ngjyrë **blu e errët**. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonalë dhe me një xhep të pasmë. Ky model shërben edhe për stërvitje.

Pamja përpara Pamja prapa

Fund ngjyrë **blu e errët** për punonjëset femra. Konstruksioni i fundit, duhet të jetë sipas modelit klasik, me gjatësi deri në mes të kupës së gjurit.

Këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë e kaltër. Këmisha në pjesën e supeve ka 2 spaleta për montimin e shenjave të supit. Mbyllja e këmishës bëhet me 7 kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit. Këmisha për femra është e njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.

Këpucë gjysma verore (për meshkuj e femra), ngjyrë e zezë, me lidhëse për punonjësit meshkuj dhe me takë për punonjëset femra.

Për meshkuj

Për femra

Kapelë tip sportive me ngjyrë blu e errët me stemën e Bashkisë në mes dhe mbishkrimin: "POLICIA BASHKIAKE".

Pamja anash

Pamja përpara

Pamja anash

Bluzë me mëngë të shkurtra e trikotuar, e hapur në mes dhe mbyllet përpara me tri kopsa të vogla. Pjesa poshtë është ngjyrë blu e errët së bashku me jakën, ndërsa pjesa sipër e kaltër. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë, ndërsa përpara në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit dhe poshtë saj mbishkrimi: "POLICIA BASHKIAKE". Ky mbishkrim është dhe në pjesën prapa. Bluza për femra është e njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.

Pamja përpara Pamja prapa

Përdoruesit e biçikletave (pantallona, bluzë, atlete).

Bluzë me mëngë të shkurtra ngjyrë e bardhë, e trikotuar, shoqëruar me ngjyrë blu të errët në pjesën e supeve. Ka dy spaleta për vendosjen e shenjave të supit, e hapur në mes dhe jakë të zezë. Mbyllja përpara bëhet me tri kopsa të vogla. Në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit dhe poshtë saj mbishkrimi: "POLICIA BASHKIAKE". Ky mbishkrim vendoset dhe në pjesën prapa. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë. Bluza për femra është e njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.

Pantallona të shkurtra ngjyrë blu të errët. Pantallonat kanë dy xhepa të përparmë diagonalë, dy xhepa në pjesën e poshtme me kapak ngjyrë të kaltër dhe dy xhepa të pasmë. Pantallonat për femra janë të njëjta, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.

Pamja përpara Pamja prapa

Atlete ngjyrë blu të errët me lidhëse.

Bluzë e brendshme verore ngjyrë e zezë me jakë rrethore, e trikotuar. Në pjesën përpara do të jetë stema e Bashkisë, ndërsa në pjesën prapa mbishkrimi: "POLICIA BASHKIAKE". Ky model shërben edhe për stërvitje.



Pamja përpara Pamja prapa

Rrip mesi ngjyrë e zezë, me tokëz metalike katrore. Gjatësia dhe gjerësia standarde.

Jelek fosforeshent ngjyrë e verdhë me dy shirita të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Shiritat janë të vendosur horizontalisht. Në pjesën përpara në krahun e majtë vendoset mbishkrimi: "POLICIA BASHKIAKE", ndërsa në krahun e djathtë vendoset shenja e gjoksit.



3. UNIFORMA CEREMONIALE

Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmishë, kravatë, kapelë, këpucë, shiritat, dorezat, rrip mesi + rrip krahëqafë).

Xhaketa e kostumit të uniformës do të jetë **blu e errët,** me spaleta për vendosjen e shenjave të supit dhe katër kopsa. Ka katër xhepa me kapak (dy xhepa të vegjël në pjesën e gjoksit dhe dy xhepa të mëdhenj të poshtëm). Te jaka vendoset elementi kryesor i stemës së Bashkisë. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë. Xhaketa e uniformës për femra është e njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra, me kopsat në anën e majtë.

Pantallonat, njëlloj me xhaketën ngjyrë **blu të errët**. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonalë dhe me një xhep të pasmë. Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pantallonat për femra kanë konstruksion të njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra.

Pamja përpara Pamja prapa

Këmishë me mëngë të gjata, ngjyrë të kaltër. Këmisha në pjesën e supeve ka 2 spaleta për montimin e shenjave të supit. Mbyllja e këmishës bëhet me 7 kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e Bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit. Këmisha për femra është e njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë. Për drejtuesin këmisha ka elemente të njëjta dhe me ngjyrë të bardhë.

Kravata blu e errët, me një shirit të hollë të kaltër dhe gjerësi maksimumi 7–8 cm.



Kapelë blu e errët, me stemën e Bashkisë në qendër, shoqëruar me shirit të gërshetuar përpara. Shiriti ngjyrë ari është për drejtorin, shiriti ngjyrë argjendi për përgjegjësin e sektorit dhe shiriti ngjyrë e kaltër për punonjësin. Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë.

Drejtuesi Përgjegjësi i sektorit Punonjësi

Shiritat janë të gërshetuara. Shiriti ngjyrë ari është për drejtuesin, shiriti ngjyrë argjendi për përgjegjësin e sektorit dhe shiriti ngjyrë e kaltër për punonjësin.



Këpucë uniforme ngjyrë të zezë dhe me lidhëse

Doreza të bardha

Rrip mesi + rrip krahëqafë e bardhë, tokëz metalike katrore me stemën e Bashkisë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË SHENJAVE DALLUESE TË POLICISË BASHKIAKE

Shenjat dalluese të Policisë Bashkiake ndahen, si më poshtë:

a) shenja e supit;

b) shenja e gjoksit;

c) shenja e krahut.

Elementet e shenjave dalluese duhet të jenë të rregullta, pa deformime apo shkëputje të konfiguracioneve. Paraqitja, forma dhe përshkrimi i shenjave dalluese të Policisë Bashkiake janë, si më poshtë:

A. SHENJA E SUPIT

Shenjat e supit ngjyrë blu të errët (1 palë) janë në formë spaleti me përmasa 14 cm x 5 cm. Kjo shenjë ka elementin dallues të stemës së bashkisë, shoqëruar me shirita. Shenja me tre shirita ngjyrë ari për drejtorin, me dy shirita ngjyrë argjendi për përgjegjësin e sektorit dhe me një shirit të kaltër për punonjësin.

B. SHENJA E GJOKSIT

Shenja e gjoksit është në formë drejtkëndëshi me përmasa 9 cm x 4 cm. Brenda shenjës vendoset stema e Bashkisë dhe numri personal. Shenja vendoset në gjoks në krahun e djathtë. Kjo shenjë është e njëjtë për drejtuesin, përgjegjësin e sektorit dhe për punonjësin e Policisë Bashkiake.



C. SHENJA E KRAHUT

Shenja e krahut është në formë mburoje me përmasa 8 cm x 6 cm. Shenja përmban stemën e bashkisë dhe mbi të mbishkrimin: "POLICIA BASHKIAKE". Kjo shenjë vendoset në krahun e majtë. Kjo shenjë është e njëjtë për drejtuesin, përgjegjësin e sektorit dhe punonjësin e Policisë Bashkiake.

URDHËR
Nr. 72, datë 31.5.2024

PËR ZËVENDËSIM TË PËRKOHSHËM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative"; të nenit 3, të ligjit nr. 41/2012, "Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridik jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë"; të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të nenit 28, pika "d", të ligjit 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa

nëpunësve publik", të ndryshuar; të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave", si dhe të ligjit nr. 138/2005, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe të urdhrit të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 76, datë 18.9.2014, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administrimit të shoqërive huamarrëse", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Znj. Lejdi Qirollari, aktualisht specialist jurist, në shoqëritë huamarrëse në administrim, ngarkohet si zëvendësues i përkohshëm, në pozicionin e administratorit të shoqërive huamarrëse në administrim.

2. Zëvendësimi i përkohshëm bëhet për të rregulluar funksionimin normal të institucionit dhe për të siguruar vijimësinë në ushtrimin e detyrave në përgjegjësi të institucionit, deri në plotësimin e pozicionit të administratorit të shoqërive huamarrëse në administrim.

3. Plotësimi i formularit të deklarimit të pasurisë "Para fillimit të detyrës" në sistemin EACIDS dhe dorëzimi i tij pranë autoritetit përgjegjës të bëhet brenda 30 ditëve nga data e fillimit të detyrës në pozicionin e zëvendësuesit të përkohshëm, të administratorit të shoqërive huamarrëse në administrim.

4. Dorëzimi i formularit të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike të plotësuar, të bëhet brenda 10 ditëve nga data e emërimit, në pozicionin e zëvendësuesit të përkohshëm, të administratorit të shoqërive huamarrëse në administrim.

5. Ky zëvendësim nuk shoqërohet me efektet financiare të pozicionit të administratorit të shoqërive huamarrëse në administrim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

1.MINISTËR I FINANCAVE
Ervin Mete

VENDIM
Nr. 40, datë 14.5.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 14.5.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 15 (L) 2023 që u përket:

KËRKUES: Lefter Koka, përfaqësuar nga avokati Tritan Hamitaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Dritan Prençi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 27, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", 135, 141, 142 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* nenet 3, 5, 6 dhe 18, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ);* nenet 27, 28 dhe 71, e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Lefter Koka *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(Prokuroria e Posaçme),* që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Ndaj kërkuesit janë regjistruar dy procedime penale: i. procedimi i parë nr. 187/2020, me akuzën për kryerjen e veprave penale "Shpërdorimi i detyrës", "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale", të parashikuara nga nenet 248 e 25, 260 e 25, 287/1, shkronjat "a" dhe "b" dhe 278/2, të Kodit Penal *(KP),* lidhur me procedurat e koncesionit/partneritetit publik me objekt "Ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë"; ii. procedimi i dytë nr. 277/2020 me të njëjtat akuza si në procedimin e parë, por në lidhje me procedurat e koncesionit/partneritetit publik me objekt "Ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan dhe prodhimin e energjisë".

2. Ndaj kërkuesit është marrë dhe ekzekutuar masa e sigurimit "Arresti në burg" për të dyja procedimet dhe respektivisht ka kërkuar zëvendësimin me një masë më të lehtë, si "Arresti në shtëpi", për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore. Në vijim, do të parashtrohen në mënyrë të detajuar të dyja proceset gjyqësore penale të zhvilluara në ngarkim të kërkuesit.

I. Procesi i parë

3. Prokuroria e Posaçme, mbi bazën e kallëzimeve të bëra nga dy parti politike dhe nga "Nisma Thurje", të cilat lidheshin me të njëjtin fakt penal, ka vendosur bashkimin e procedimeve penale dhe ka regjistruar për kërkuesin procedimin nr. 187 të vitit 2020 për veprat penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" dhe "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuara nga nenet 258 dhe 248 të KP-së. Akuzat ndaj kërkuesit lidheshin me procedurat e zhvilluara në Bashkinë Fier për hartimin e planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane.

4. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(GJKKO e Shkallës së Parë),* me vendimin nr. 22 akti, datë 26.3.2022, midis të tjerave, ka vendosur ndaj kërkuesit caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg", të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale *(KPP),* si i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Shpërdorimi i detyrës", të kryer në bashkëpunim, "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale", të kryer në bashkëpunimin, të parashikuara përkatësisht nga nenet 248 e 25, 260 e 25, 287/1, shkronjat "a" dhe "b", dhe 278/2 të KP-së.

5. Masa e sigurimit është ekzekutuar nga oficerët e Policisë Gjyqësore në datën 29.3.2022. Me vendimin nr. 23, datë 31.3.2022, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka verifikuar kushtet dhe kriteret e caktimit të masës së sigurimit, bazuar në nenin 248 të KPP-së, duke disponuar me vazhdimin e masës "Arresti në burg", të caktuar me vendimin e sipërcituar.

6. Në datën 15.6.2022, kërkuesi i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës të Parë, duke kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit personal të arrestit në burg me një masë tjetër më të lehtë, "Arresti në shtëpi", për shkak të gjendjes shëndetësore të përkeqësuar, së bashku me masën e sigurimit "garanci pasurore".

7. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 269, datë 14.10.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj dhe në prova. Gjatë procesit, pas kërkesës së gjyqtarit të GJKKO-së është hartuar aktekspertimi mjekoligjor nr. 1742 nga mjekë specialistë të fushës për ekzaminimin në lidhje me vlerësimin e gjendjes shëndetësore të kërkuesit.

8. Kundër vendimit kërkuesi ka ushtruar ankim në apel dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

(GJKKO e Apelit), me vendimin nr. 180, datë 24.11.2022, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 269, datë 14.10.2022, të GJKKO-së së Shkallës së Parë.

9. Kundër vendimit nr. 180, datë 24.11.2022, të GJKKO-së së Apelit ka ushtruar rekurs kërkuesi dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi masa e sigurimit "Arresti në burg" ishte rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural penal.

II. Procesi i dytë

10. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 100 akti, datë 12.12.2021, midis të tjerave, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Arresti në burg", të parashikuar nga neni 238 i KPP-së, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Shpërdorimi i detyrës", të kryer në bashkëpunim, "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale", të kryer në bashkëpunim, të parashikuara përkatësisht nga nenet 248 e 25, 260 e 25, 287/1, shkronjat "a" dhe "b", dhe 278/2 të KP-së. Akuzat ndaj kërkuesit lidheshin me procedurat e zhvilluara në Bashkinë Elbasan për hartimin e planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane.

11. Masa e sigurimit është ekzekutuar në datën 14.12.2021. Me vendimin nr. 103, datë 16.12.2021, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka verifikuar kushtet dhe kriteret, sipas nenit 248 të KPP-së, dhe ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit "Arresti në burg".

12. Në datën 5.7.2022, kërkuesi i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit personal të caktuar me vendimin nr. 100 akti, datë 12.12.2021, të GJKKO-së së Shkallës së Parë me një masë më të lehtë për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore.

13. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 297, datë 25.11.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj dhe në prova. Gjatë procesit, pas kërkesës së gjyqtarit të GJKKO-së, është hartuar aktekspertimi mjekoligjor nr. 2555 për ekzaminimin nga mjekë specialistë të fushës në lidhje me gjendjen shëndetësore të kërkuesit.

14. Kundër vendimit ka ushtruar ankim kërkuesi dhe GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 3, datë 5.1.2023, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 297, datë 25.11.2022, të GJKKO-së Shkallës së Parë.

15. Kundër vendimit nr. 3, datë 5.1.2023, të GJKKO-së së Apelit ka ushtruar rekurs kërkuesi dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, ka vendosur mospranimin e tij, pasi masa e sigurimit ishte rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural penal.

16. Në datën 17.10.2023 *(data e shërbimit postar)* kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata),* duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023 dhe nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës, në datën 5.12.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

17. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

17.1 *Trajtimin degradues, sipas nenit 3 të KEDNJ-së,* pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe gjykatat e posaçme kanë rrëzuar *apriori* mendimin e specializuar të mjekëve, si ekspertë, të cilët kanë arritur në përfundimin se mbajtja e kërkuesit në kushtet e burgimit është e papërshtatshme me gjendjen e tij shëndetësore, pavarësisht mundësisë së tij për të marrë mjekim. Gjykatat kanë arritur në një përfundim të kundërt me mendimin e ekspertëve dhe nuk kanë përmbushur detyrimin për të thirrur një grup tjetër ekspertësh për të konfirmuar ose rrëzuar aktin e ekspertimit. Analiza e Gjykatës së Lartë për të përdorur si kriter veprat penale, për të cilat akuzohet kërkuesi, bie në kundërshtim me natyrën e nenit 3 të KEDNJ-së, i cili mbron një të drejtë absolute. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* ka pranuar se lirimi në situata të tilla mund të parashikohet edhe për persona shumë të rrezikshëm. Kërkuesit, duke mos iu ndryshuar masa e sigurimit, i janë rrezikuar jeta dhe shëndeti, pasi në kushtet e

burgimit, nuk mund t'i ofrohet kujdes shëndetësor i shpejtë.

17.2 *Cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

17.2.1 *Lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi në të gjitha vendimet që kanë miratuar masën e arrestit në burg, gjykatat, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, nuk kanë analizuar domosdoshmërinë e masës së sigurimit të arrestit në burg. Shkaku për zëvendësimin e masës së sigurimit ka qenë gjendja e rënduar shëndetësore dhe se qëndrimi në paraburgim mund t'i dëmtojë rëndë shëndetin dhe jetën. Kushtet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale *(IEVP)*, Durrës se nuk ka autoambulancë, mungon stafi mjekësor, ka mbipopullim dhe protokolli i Policisë së Burgjeve nuk lejon që pacienti i paraburgosur të marrë të njëjtin shërbim si një pacient civil, janë konstatuar edhe nga institucioni i Avokatit të Popullit. Pretendimet e paraqitura në rekurs ishin të natyrës kushtetuese, sepse lidheshin me të drejtën e lirisë personale dhe lëvizjes së lirë, të parashikuar nga neni 27 i Kushtetutës. Vendimi i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë nuk është mjaftueshëm i arsyetuar, argumentet janë të përgjithshme e abstrakte, si dhe nuk janë argumentuar arsyet për rrëzimin e kërkesës për caktimin e masave alternative shtrënguese më të lehta. Ndonëse në rekurs ishin parashtruar pretendime që lidhen me interpretimin e neneve 228, 229 dhe 230 të KPP-së, nuk është dhënë përgjigje e argumentuar dhe i është shmangur arsyetimit të kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është kontradiktor në vendim dhe nuk ka arsyetuar për tre kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.

17.2.2 *Së drejtës së aksesit në gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive,* pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka zbatuar afatin ligjor 30-ditor për njoftimin e datës së seancës gjyqësore. Për çështjen e përfunduar me vendimin nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në dosje mungon shpallja e bërë në këndin e njoftimeve të asaj gjykate dhe nuk ka asnjë të dhënë për caktimin e gjyqtarit zëvendësues, ndërsa për procesin e përfunduar me vendimin nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, rezulton se gjyqtari zëvendësues është caktuar me short manual ditën e gjykimit dhe në buletinin e njoftimeve nuk është njoftuar data e re, si dhe gjyqtari zëvendësues. Për të gjitha këto arsye trupi gjykues që ka shqyrtuar rekursin është krijuar në kundërshtim me nenin 436, paragrafi 2, të KPP-së, duke cenuar edhe *të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*.

17.2.3 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi vendimi i trupit gjykues prej tre gjyqtarësh bie ndesh me praktikën e Gjykatës së Lartë, që ka pranuar se zbutja e masave të sigurimit mund të jetë edhe pasojë e gjendjes së rënduar shëndetësore të kërkuesit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta dërgonte çështjen për njësim të praktikës gjyqësore lidhur me faktin nëse për zëvendësimin e masës së sigurimit nevojitet një aktekspertimi mjekoligjor për konstatimin e gjendjes shëndetësore, kur kujdesi shëndetësor i të paraburgosurit është i njëjtë me personin në gjendje të lirë, si dhe nëse praktikisht këta dy persona mund të kenë kujdes shëndetësor në kushte të njëjta. Qëndrimi ndryshe i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë ka *cenuar edhe parimin e sigurisë juridike*.

18. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme,* në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet për mospranimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore lidhen me zbatimin e ligjit procedural dhe material nga gjykatat. Akti i ekspertimit mjekoligjor nuk është detyrues, por ndihmues për gjykatën në lidhje me formimin e bindjes së saj, duke u bazuar në rrethanat faktike dhe konkluzionet shkencore. Nga ana tjetër, duhet të konsiderohet edhe humbja e vlerës në kohë të aktit, i cili ka bërë një vlerësim të situatës shëndetësore në datën 29.7.2022 dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka të dhëna nga Drejtoria e Burgjeve për kërkesë nga personeli mjekësor i IEVP-së, Durrës, ku mbahet kërkuesi, për një trajtim mjekësor të specializuar. Ligji nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" *(ligji nr. 81/2020)* i siguron personit nën hetim të gjitha kushtet: mjekësore, përshtatshmërinë e ndihmës dhe të përkujdesjes mjekësore, si dhe garantimin e masave të burgimit në përputhje me gjendjen shëndetësore, në zbatim edhe të

jurisprudencës së GJEDNJ-së. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se akti i ekspertimit mjekoligjor nuk është bindës dhe se çështja konkrete nuk është në të njëjtat kushte si rastet e referuara nga praktika e GJEDNJ-së për zëvendësimin e masës së sigurimit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

19. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134 dhe pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

20. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues, do të vlerësohet legjitimimi i kërkuesit, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

21. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proceset gjyqësore penale në të cilat janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

22. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 17.3.2022; nr. 14, datë 11.3.2022; nr. 29, datë 30.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Si përjashtim, Gjykata ka vlerësuar se vendimet që lidhen me masën e sigurimit të arrestit me burg, konsiderohen përfundimtare për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 75, datë 22.12.2015; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Rregulli i shterimit të mjeteve juridike nënkupton jo vetëm që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, por edhe që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë, t'i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese).*

23. Në përmbushjen e këtij kriteri, Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet për masën e sigurimit të arrestit në burg bazuar në kërkesën për zëvendësimin e saj. Po kështu, Gjykata konstaton se të gjitha pretendimet e paraqitura në ankimin kushtetues individual janë parashtruar përpara gjykatave të posaçme, pra në këtë kuptim ato përmbushin kriterin e shterimit edhe në substancë, jo vetëm në formë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

24. Gjykata vëren se për legjitimimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, kërkuesi ka pretenduar se për vendimet e Kolegjit Penal ka marrë dijeni në datën 25.8.2023, ditën kur ka aplikuar për të marrë vendimet e Kolegjit Penal. Në mbështetje të pretendimit të tij, kërkuesi ka parashtruar se vendimet objekt kundërshtimi nuk i janë njoftuar, fakt i konfirmuar edhe nga shkresa nr. 2178/1 prot., datë 8.9.2023, e GJKKO-së së Shkallës së Parë, e cila ka sqaruar se pas verifikimit të dosjes gjyqësore, në fashikullin gjyqësor të Gjykatës së Lartë nuk ndodhet dëftesa e komunikimit të vendimit nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës

së Lartë. Vendimet janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 18.5.2023, por kërkuesi ka paraqitur një shkresë të IEVP-së, Durrës, sipas së cilës ai nuk ka mundësi përdorimi të internetit në mjediset e paraburgimit.

25. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se, në rastin konkret në kushtet e veçanta që ndodhet kërkuesi, ato të izolimit në IEVP, Durrës, nisur nga data 25.8.2023 kur ai ka pasur mundësi të njihet efektivisht me vendimet, ankimi kushtetues individual i paraqitur në datën 17.10.2023, konsiderohet brenda afatit ligjor 4-mujor.

26. Lidhur me kriterin e legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar se vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë janë rrjedhojë e një procesi të parregullt për shkak të cenimit të: i. nenit 3 të KEDNJ-së (trajtimi degradues); ii. lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor; iii. së drejtës së aksesit në gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me mbrojtjen efektive; iv. së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

27. Gjykata vëren se për pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me mbrojtjen efektive, kërkuesi ka parashtruar se kjo e drejtë është cenuar për shkak të mosrespektimit të rregullave të shortit për caktimin dhe ndryshimin e gjyqtarëve të trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, si dhe për shkak të moszbatimit të afatit 30-ditor për njoftimin e datës së seancës, duke mos i dhënë mundësi të paraqesë parashtrimet e tij.

28. Për pretendimin për mozbatimin e rregullave të shortit dhe zbatimin e shortit manual për caktimin e gjyqtarit zëvendësues, Gjykata konstaton se nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të vendimit nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, në datën 2.2.2023, është bërë njoftimi me shpallje për zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit në datën 16.2.2023. Po në datën 16.2.2023, ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi një gjyqtar i trupit gjykues dhe me vendimin nr. 82 prot., datë 16.2.2023, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur pranimin e saj. Në datën 17.2.2023, është bërë njoftimi me shpallje për zhvillimin e seancës në datën 23.2.2023, duke njoftuar edhe përbërjen e trupit gjykues. Ndërsa në lidhje me procesin gjyqësor të përfunduar me vendimin nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, rezulton se njoftimi me shpallje mban datën 10.2.2023, për zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit në datën 16.2.2023. Po këtë ditë ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga ky gjykim i njëjti gjyqtar i trupit gjykues, si në procesin e parë. Me vendimin nr. 81 prot., datë 16.2.2023, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur pranimin e saj. Në datën 17.2.2023, është mbajtur procesverbal për plotësimin e trupit gjykues për shkak të heqjes dorë nga gjykimi i çështjes të gjyqtarit dhe po këtë ditë është bërë shpallja për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në datën 23.2.2023, duke njoftuar edhe përbërjen e trupit gjykues.

29. Në analizë të rrethanave të mësipërme, Gjykata vëren se nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë mosrespektimin e rregullave procedurale në Gjykatën e Lartë për caktimin e trupit gjykues dhe zëvendësimin e një prej anëtarëve. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se çështja e kërkuesit në Gjykatën e Lartë është ndarë me short elektronik, duke iu caktuar njërit prej gjyqtarëve të kolegjit të saj penal, ndërsa trupi gjykues është formuar edhe me dy anëtarë të tjerë, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Gjykatës për shpërndarjen e gjyqtarëve në trupa gjykues. Në vijim, Gjykata vëren se për shkak të largimit (me dorëheqje) të një prej anëtarëve të trupit gjykues, ai është zëvendësuar nga një gjyqtar tjetër po i Kolegjit Penal, i përzgjedhur me short, i cili në këtë rast është kryer manualisht. Lidhur me këtë, Gjykata vlerëson se shorti manual nuk është një praktikë e përjashtuar në caktimin e gjyqtarëve, gjithmonë kur ajo bëhet në funksion të mirëadministrimit të drejtësisë dhe menaxhimit efektiv të situatave që mund të lindin në raste të veçanta. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente konkrete në mbështetje të pretendimit për të provuar se si zbatimi i këtij mekanizmi përzgjedhjeje të një prej anëtarëve të trupit gjykues ka cenuar procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në drejtim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

30. Lidhur me pretendimin për mosrespektimin e afatit ligjor 30-ditor të

përcaktuar nga KPP-ja për njoftimin e datës së seancës, Gjykata evidenton se, referuar dispozitave që rregullojnë rekursin në Gjykatën e Lartë, shqyrtimi në këtë gjykatë kalon në një ose në dy faza. Në fazën seleksionuese, sipas nenit 433 të KPP-së, shqyrtohen në dhomën e këshillimit kushtet e pranueshmërisë së rekursit dhe në mungesë të tyre Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë disponon me mospranimin e tij, duke i dhënë fund shqyrtimit. Vetëm nëse rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore (faza e dytë), që, si rregull, zhvillohet në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve (neni 436/a i KPP-së) ose në prani të palëve (neni 437 i KPP-së), rast në të cilin bëhet edhe njoftimi i palëve për datën dhe orën e gjykimit sipas mënyrave përkatëse të përcaktuara nga KPP-ja (neni 436).

31. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa/rekursi për zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" me një masë më të lehtë i është nënshtruar shqyrtimit seleksionues nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili në dhomën e këshillimit (pa pjesëmarrjen e palëve) ka vendosur mospranimin e saj, pasi nuk plotësonte kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në këtë drejtim, bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesit nuk i është mohuar e drejta për t'u njoftuar dhe më tej mbrojtja efektive, pasi në fazën seleksionuese ligji nuk parashikon njoftimin e palëve, për rrjedhojë pretendimi për mosrespektimin e afatit ligjor 30-ditor për njoftimin e seancës nuk qëndron. Po kështu, Gjykata evidenton se, për shkak të natyrës së çështjes që lidhet me një masë paraburgosjeje, pra me lirinë e personit, shqyrtimi me shpejtësi i çështjes nga gjykatat përbën detyrim që vjen nga neni 28, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 5, pika 3, i KEDNJ-së, që i korrespondojnë së drejtës së personit të paraburgosur për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

32. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me mbrojtjen efektive është haptazi i pabazuar.

33. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike, pasi vendimet e Kolegjit Penal bien në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se vendimet e referuara nga kërkuesi nuk janë njësuese të praktikës gjyqësore, për rrjedhojë nuk janë detyruese për zbatim gjatë shqyrtimit të një çështjeje nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Për sa i përket pretendimit se çështja duhej të kishte kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, për qëllim të njësimit të praktikës gjyqësore, Gjykata vlerëson se kjo është një çështje e mënyrës së zbatimit të ligjit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili vlerëson nëse në një çështje të caktuar është përpara rastit për të vendosur kalimin për shqyrtim në seancë gjyqësore në prani të palëve, sipas nenit 437 të KPP-së ose njësimin e praktikës, sipas nenit 438 të po këtij kodi. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe për pretendimin për cenimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike kërkuesi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese.

34. Në vijim, Gjykata konstaton se kërkuesi edhe në lidhje me cenimin e nenit 3 të KEDNJ-së, për trajtimin degradues, nuk ka parashtruar argumente konkrete, por pretendimet i ka lidhur me mënyrën e arsyetimit të Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë tjetër më të lehtë për shkak të gjendjes shëndetësore, ndaj Gjykata çmon ta analizojë çështjen në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, Gjykata do të analizojë bazueshmërinë në themel të pretendimeve në drejtim të cenimit të lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

35. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar se në të gjitha vendimet, gjykatat, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, nuk kanë analizuar domosdoshmërinë e masës së sigurimit të arrestit në burg. Shkaku për zëvendësimin e masës së sigurimit ka qenë gjendja e rënduar shëndetësore dhe se qëndrimi në paraburgim mund t'i dëmtojë rëndë shëndetin dhe jetën. Pretendimet në rekurs ishin të natyrës

kushtetuese, sepse lidheshin me lirinë personale. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk është mjaftueshëm i arsyetuar, është kontradiktor, argumentet janë të përgjithshme e abstrakte, dhe ky kolegj nuk ka arsyetuar për tre kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.

36. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, duke konfirmuar qëndrimin e gjykatave të posaçme më të ulëta për zbatimin e ligjit nr. 81/2020, për trajtimin shëndetësor të tij dhe se në rastin konkret nuk jemi përpara rasteve të referuara nga praktika e GJEDNJ-së për zëvendësimin e masës së sigurimit. Akti i ekspertimit mjekoligjor nuk është detyrues, por ndihmues për gjykatën në lidhje me formimin e bindjes së saj dhe pretendimet lidhen me zbatimin e ligjit nga gjykatat.

37. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shkronja "c"*).

38. Sipas Gjykatës, kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe konkretisht me lirinë e personit (*shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Masa e sigurimit personal mund dhe duhet të ndryshohet, duke u zëvendësuar me një më të lehtë ose më të rëndë, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistonin kur ajo është caktuar *(shih vendimin nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

39. Në lidhje me zbutjen e nevojave të sigurimit, GJEDNJ-ja ka përcaktuar tre elemente/kritere referuese: i. kushtet mjekësore të të burgosurit; ii. përshtatshmërinë e ndihmës dhe përkujdesjes mjekësore, të parashikuar sipas kushteve spitalore të burgut; iii. përshtatshmërinë e masës së sigurimit në përputhje me gjendjen shëndetësore të ankuesit *(shih Melnik kundër Ukrainës, datë 28.3.2006, § 94).*

40. Referuar nenit 260, pika 2, të KPP-së gjykata e zëvendëson masën e sigurimit me një tjetër më të lehtë kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet. Ndërsa në pikën 2, të nenit 230 të po këtij kodi, mes të tjerave, parashikohet se "Arresti në burg" nuk mund të vendoset ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë.

41. Për sa i takon standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore (*shih vendimet nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit kushtetues, vendimi për kufizimin e lirisë personale të kërkuesit është bërë bazuar në rezultatet e hetimit dhe materialet për secilën çështje. Nga analiza tërësore e fakteve, rrethanave dhe akteve, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, për të dyja procedimet penale, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit "Arresti në burg", për të cilat kërkuesi ka kërkuar zëvendësimin me një masë më të lehtë, "Arresti në shtëpi", për

shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore si pasojë e sëmundjeve.

44. Pas shqyrtimit të çështjes GJKKO-ja e Shkallës së Parë (në të dyja proceset) ka vendosur rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, duke arsyetuar se pavarësisht përfundimit të ekspertëve se gjendja shëndetësore aktuale e kërkuesit paraqitet "veçanërisht e rëndë", ky konkluzion nuk është i detyrueshëm për gjykatën dhe se kjo gjendje nuk mund të interpretohet *apriori* si një rrethanë që pengon caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg. GJKKO-ja e Shkallës së Parë (në të dyja proceset) ka arsyetuar se rregulli që ndaj një personi në gjendje veçanërisht të rëndë nuk mund të caktohet masa e sigurimit e arrestit të burg është i përgjithshëm dhe se në rastin konkret gjen zbatim pika 3, e nenit 230 të KPP-së, sipas së cilës arresti në burg mund të vendoset vetëm për shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se 10 vjet burgim. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë (në të dyja proceset), sëmundjet që i janë diagnostikuar kërkuesit mund të ndikojnë në gjendjen e tij shëndetësore kudo që të ndodhet, në mjediset e shtëpisë, të IEVP-së ose Institucionit të Veçantë të Kujdesit Shëndetësor të të Burgosurve, pasi trajtimi i tyre është i njëjtë si në kushtet e paraburgimit, ashtu edhe në mjediset e tjera, prandaj në rastin në shqyrtim nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë që të përligjë zbutjen e masës së sigurimit, në përputhje me kërkesat e nenit 260 të KPP-së.

45. Pas ankimit të kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit (në të dyja proceset) ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar në të njëjtën linjë si GJKKO-ja e Shkallës së Parë se në rastin konkret nuk provohet pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese përkatëse në institucionin mjekësor ku trajtohen të paraburgosurit ose në një institucion të specializuar mjekësor. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se mendimi i ekspertëve se sëmundjet nga të cilat vuan kërkuesi nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit tejkalon fushën shkencore që ata mbulojnë dhe se autoriteti kompetent që konfirmon mundësinë ose pamundësinë e ofrimit të kujdesit shëndetësor gjatë paraburgimit është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas ligjit nr. 81/2020. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se në rastin e kërkuesit ofrohet kurimi i përshtatshëm edhe gjatë zbatimit të masës së arrestit në burg dhe ky trajtim është në një nivel proporcional me trajtimin që shteti shqiptar u siguron qytetarëve të tij në tërësi, e, për pasojë në respektim të ndalimeve të nenit 3 të KEDNJ-së. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se nuk verifikohet prania e gjendjes "veçanërisht e rëndë", siç kërkon paragrafi 2, i nenit 230 të KPP-së.

46. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në të dyja proceset, ka vendosur mospranimin. Ky Kolegj Penal, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se edhe pse në disa vendime është mbajtur qëndrimi se jo çdo sëmundje e të arrestuarit mund të trajtohet si rast për mosaplikimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" ose për zëvendësimin e saj me një masë tjetër më të lehtë, me përjashtim të rastit kur ndodhemi përpara një gjendjeje "veçanërisht të rëndë shëndetësore", një rrethanë e tillë nuk mund të merret *"apriori",* duke u mbështetur në çfarëdolloj pretendimi të palës kërkuese, pasi gjykata arrin në përfundim vetëm nëpërmjet një aktekspertimi mjekoligjor, të caktuar sipas rregullave procedurale penale, në konkluzionet e të cilit duhet të përcaktohet qartë "gjendja veçanërisht e rëndë shëndetësore" e të arrestuarit, njëkohësisht edhe "pamundësia e qëndrimit të mëtejshëm në izolim ose në kushtet spitalore të burgut". Në arsyetim, Kolegji Penal, mes të tjerave, ka vlerësuar se nga ana e ekspertëve nuk është provuar pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese përkatëse në institucionin mjekësor ku trajtohen të paraburgosurit ose në një institucion të specializuar mjekësor. Në lidhje me pajtueshmërinë e gjendjes shëndetësore të personit nën hetim, në zbatim të tre kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, Kolegji Penal është shprehur se vetëm në ato raste kur nga ana e autoritetit shtetëror mbikëqyrës të paraburgimit nuk mund të sigurohet një trajtim i kualifikuar mjekësor i sëmundjes dhe mungesa e tij vë në rrezik jetën ose shëndetin, gjendja shëndetësore e personit mund të shërbejë si shkak për ndryshimin e masës së sigurimit *(shih paragrafët 37–38, të vendimit nr. 00-2023-313 dhe 51–54, të vendimit nr. 00-2023-335, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

47. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vijuar me arsyetimin se ligji nr. 81/2020 garanton të drejtën e trajtimit mjekësor në institucionet e ekzekutimeve penale dhe se kërkuesi ka të drejtë të kryejë vizitat mjekësore në një institucion të kujdesit shëndetësor brenda vendit të zgjedhur prej tij, përfshirë këtu edhe një spital privat (edhe pse ai është nën masën e sigurimit "Arresti në burg"). Sipas tij, kërkuesi është trajtuar pranë Institucionit të Veçantë të Kujdesit Shëndetësor të të Burgosurve, duke marrë trajtimin e kualifikuar mjekësor dhe me konsulta të herëpashershme me specialistë të fushës, për rrjedhojë Kolegji Penal ka vlerësuar se nuk ndodhet përpara kritereve të përcaktuara nga GJEDNJ-ja dhe nuk ka vend për zëvendësimin e masës së sigurimit për shkak të gjendjes shëndetësore *(shih paragrafët 40, 41.3. dhe 42, të vendimit nr. 00-2023-313 dhe 59, të vendimit nr. 00-2023-335, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

48. Për sa më lart, duke pasur në vëmendje kriteret e vendosura nga GJEDNJ-ja për zbutjen e masave të sigurimit, Gjykata vlerëson se nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është arsyetuar vazhdimi i masës së sigurimit të arrestit në burg, duke konsideruar kushtet mjekësore të kërkuesit *(kriteri i parë),* që pavarësisht vlerësimit të mjekëve është konkluduar se mund të kurohet në mjediset e paraburgimit, pra nuk është provuar pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese si në institucionin mjekësor kur trajtohen të paraburgosurit, ashtu edhe në një institucion të specializuar mjekësor, duke u përshtatur ndihma dhe përkujdesja mjekësore ndaj tij (*kriteri i dytë)* dhe se verifikimi i vazhdimësisë së masës së sigurimit të arrestit në burg është në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore *(kriteri i tretë).* Po kështu, kjo gjykatë, në rastin konkret, ka analizuar nëpërmjet një interpretimi sistematik, bazuar në kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 81/2020 dhe dispozitat e KPP-së, përmes të cilave u ka dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkuesit për cenimin e lirisë personale dhe mosplotësimin e kritereve për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg me një masë më të lehtë.

49. Në vështrim të analizës së mësipërme dhe standardeve kushtetuese e konventore, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

50. Në përfundim, Gjykata çmon se nuk ka shkelje të nenit 27 të Kushtetutës, të lidhur me nenin 42 të saj, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj dhe kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 14.5.2024.

Shpallur, më 18.6.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Ilir Toska, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

Anëtar kundër: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Lefter Koka, me objekt shfuqizimin e dy vendimeve të Gjykatës së Lartë të dhëna në datën 23.2.2023 dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë që ajo duhej të ishte pranuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Në vitin 2020 ndaj kërkuesit janë regjistruar dy procedime penale për akuzat e veprave penale të parashikuara nga nenet 248 e 25, 260 e 25, 287/1, shkronjat "a" dhe "b", dhe 278/2 të KP-

së lidhur me procedurat e koncesionit/ partneritetit publik për ndërtimin dhe administrimin e dy impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane për prodhimin e energjisë për qarqet Fier dhe Elbasan. Për të dyja procedimet është urdhëruar masa e sigurimit personal e arrestit në burg.

3. Pas caktimit të masave të sigurimit për të dyja proceset penale (në datat 12.12.2021 dhe 26.3.2022), kërkuesi i është drejtuar gjykatës respektivisht pas 7 muajve (në datën 5.7.2022) dhe rreth 3 muajve (në datën 15.6.2022) me dy kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me atë të arrestit në shtëpi për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore. Gjatë gjykimit të kërkesave është urdhëruar kryerja e ekspertimit mjekoligjor të kërkuesit, ku në përfundim ekspertët kanë konkluduar se qëndrimi në izolim, në kushtet e paraburgimit, referuar diagnozës, përbën rrezik për shëndetin e tij, pasi *"sëmundjet nga të cilat ai vuan nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit, në ambientet e IEVP-së në të cilat ndodhet"*.

4. Pavarësisht kësaj, gjykatat e të tria shkallëve e kanë rrëzuar kërkesën për ndryshimin e masës së sigurimit, duke u shprehur, ndër të tjera, se konkluzioni i ekspertëve se gjendja shëndetësore aktuale e kërkuesit paraqitet "veçanërisht e rëndë", nuk është i detyrueshëm për gjykatën dhe se kjo gjendje nuk mund të interpretohet *apriori* si një rrethanë që pengon caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg. Gjithashtu, sipas gjykatave, nuk provohet pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese përkatëse në institucionin mjekësor ku trajtohen të paraburgosurit ose në një institucion të specializuar mjekësor. Ato kanë vlerësuar se mendimi i ekspertëve se sëmundjet nga të cilat vuan kërkuesi nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit tejkalon fushën shkencore që ata mbulojnë dhe se autoriteti kompetent që konfirmon mundësinë ose pamundësinë e ofrimit të kujdesit shëndetësor gjatë paraburgimit është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Po kështu, kërkuesit i ofrohet kurimi i përshtatshëm edhe gjatë zbatimit të masës së arrestit në burg dhe ky trajtim është në një nivel proporcional me trajtimin që shteti shqiptar u siguron qytetarëve të tij në tërësi.

5. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës, duke pretenduar se vendimet e kundërshtuara janë rrjedhojë e një procesi të parregullt për shkak të cenimit të: i. të nenit 3 të KEDNJ-së (trajtim degradues); ii. standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me lirinë personale; iii. së drejtës së aksesit në gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me mbrojtjen efektive; iv. së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike. Shumica dy pretendimet e fundit i ka vlerësuar si haptazi të pabazuara dhe të paparashtruara me argumente kushtetuese (*shih paragrafët 29, 32 dhe 33, të vendimit*). Ndërsa lidhur me pretendimin për trajtimin degradues, sipas nenit 3 të KEDNJ-së, ka evidentuar se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente konkrete duke e analizuar atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe konkretisht në drejtim të cenimit të lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih paragrafin 34 të vendimit*).

6. Në përfundim, shumica ka rrëzuar kërkesën, duke argumentuar se Gjykata e Lartë ka arsyetuar vazhdimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, duke konsideruar kushtet mjekësore të kërkuesit dhe që pavarësisht vlerësimit të mjekëve, nuk është provuar pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese, qoftë në institucionin mjekësor kur trajtohen të paraburgosurit, ashtu edhe në një institucion të specializuar mjekësor, duke u përshtatur ndihma dhe përkujdesja mjekësore ndaj tij dhe se vazhdimësia e masës të arrestit në burg është në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore. Po kështu, sipas shumicës, ajo gjykatë ka analizuar rastin konkret nëpërmjet një interpretimi sistematik, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 81/2020 dhe dispozitat e KPP-së, përmes të cilave u ka dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkuesit lidhur me cenimin e lirisë personale dhe mosplotësimin e kritereve për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg me një masë më të lehtë (*shih paragrafin 48 të vendimit*).

7. Në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtarët në pakicë çmojmë se çështja duhej të ishte analizuar nëse ishin përmbushur garancitë procedurale të të paraburgosurit, të parashikuara nga neni 28, pikat 3 dhe 5, të Kushtetutës të lidhura me nenin 25 të saj, dhe jo në këndvështrim të nenit 27 të

saj, sikurse e ka trajtuar shumica. Kjo, pasi kërkuesi në ankimin kushtetues individual nuk ka kundërshtuar caktimin e masave të sigurimit të arrestit në burg *per se*, por ka ngritur pretendime për mënyrën se si është trajtuar nga institucionet publike dhe gjykatat gjatë paraburgimit të tij, kur ato nuk i kanë pranuar kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore. Duke mbajtur në konsideratë thelbin e pretendimeve, vëmë në dukje se neni 28 i Kushtetutës, në pikat 3 dhe 5, parashikon se personi, të cilit i është hequr liria, ka të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjyqtarit, si dhe të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij. Ndërsa neni 25 i Kushtetutës ndalon, ndër të tjera, që kushdo t'i nënshtrohet trajtimit çnjerëzor. Mbi këtë bazë kushtetuese, në vlerësimin tonë për zgjidhjen e çështjes kushtetuese konkrete vlejnë tre argumentet kryesore të mëposhtme.

8. Së pari, shtetit i lind detyrimi të ofrojë kujdesin e duhur mjekësor ndaj kujtdo dhe në çdo lloj gjendjeje që mund të ndodhet individi, jo vetëm si objektiv social, në kuptimin e përmirësimit të vazhdueshëm të standardit shëndetësor (neni 59 i Kushtetutës), por edhe për shkak se sipas nenit 55 të Kushtetutës shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti. Në këtë pikëpamje, shteti ka detyrim të shtuar për të ofruar kujdesin e duhur mjekësor ndaj atyre që ndodhen në kushtet e kufizimit të lirisë, të cilët janë të izoluar dhe ndihma eventuale mjekësore mund dhe duhet t'i ofrohet vetëm nga institucionet shtetërore. Sikurse ka theksuar edhe Gjykata në jurisprudencën e saj në rastin e kësaj kategorie individësh, liria e të cilëve është kufizuar sipas ligjit, organet e pushtetit publik kanë detyrime shtesë për të dëshmuar se të drejtat kushtetuese të tyre respektohen dhe, pikërisht për këtë arsye, nenet 27 dhe 28, të Kushtetutës parashikojnë garanci specifike për këtë kategori individësh, ku ritheksohet në mënyrë të veçantë se çdo person, të cilit i është hequr liria, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij (*shih vendimin nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Lidhur me këtë, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka pohuar se neni 3 i KEDNJ-së i imponon shtetit një detyrim për të mbrojtur mirëqenien fizike të personave të privuar nga liria, duke u ofruar, ndër të tjera, kujdesin e nevojshëm mjekësor (*shih Kudła kundër Polonisë [DhM], datë 26.10.2000, § 94*). "Përshtatshmëria" e ndihmës mjekësore mbetet elementi më i vështirë për t'u përcaktuar. Kështu në rast të mendimeve të ndryshme mjekësore për kujdesin e nevojshëm mjekësor, mund të jetë e nevojshme që autoritetet e burgut dhe gjykatat vendase, në mënyrë që të përmbushin detyrimin e tyre pozitiv, sipas nenit 3, të marrin mendim shtesë nga ekspertë të specializuar (*shih Wenner kundër Gjermanisë, datë 1.9.2016, § 57*). Për më tepër, trajtimi mjekësor i ofruar brenda mjediseve të burgut duhet të jetë i përshtatshëm, pra në një nivel të krahasueshëm me atë që autoritetet shtetërore janë zotuar t'i ofrojnë popullatës në tërësi (*shih Blokhin kundër Rusisë [DhM], datë 23.3.2016, § 137*).

10. Edhe në analizë të nenit 5 të KEDNJ-së, ajo gjykatë ka theksuar se ndonëse neni 5 i Konventës "nuk imponon një detyrim për gjyqtarin për t'i kthyer përgjigje çdo pretendimi të kërkuesit, thelbi i garancive të tij do të cenohej nëse gjyqtari, duke u mbështetur në ligjin dhe praktikën e brendshme, do të trajtonte si të parëndësishme, ose të shpërfillte fakte konkrete të paraqitura nga i paraburgosuri, të cilat do të vinin në dyshim ekzistencën e kritereve për "ligjshmërinë" e heqjes së lirisë, në kuptimin e Konventës" (*shih Nikolova kundër Bullgarisë [DhM], datë 25.8.1999, § 61*). Në këtë kontekst, "argumentet pro dhe kundër lirimit nuk duhet të jenë "të përgjithshme dhe abstrakte"" (*shih Smirnova kundër Rusisë, datë 24.7.2003, § 63*).

11. Në zbatim të standardeve të mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se në rastet e kufizimit të lirisë personale, shtetit i lind detyrimi i shtuar për të ofruar kujdesin e nevojshëm mjekësor. Detyrimi kushtetues për trajtimin njerëzor të të paraburgosurve, që sanksionohet në nenin 28, pika 5, të Kushtetutës, rezulton i përmbushur në nivel ligjor nga ligji nr. 81/2020, i cili përmban garancitë për gjendjen shëndetësore, të cilat janë vënë në dukje edhe nga gjykatat e zakonshme (*shih paragrafin 57 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në shtesë, edhe vetë KPP-ja i jep të drejtën të paraburgosurit që të paraqesë në gjykatë kërkesa për zëvendësimin e masës së

sigurimit kur nevojat e sigurimit zbuten (*neni 260*) dhe, gjithashtu, vë në dukje se arresti në burg nuk mund të caktohet ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë (*neni 230*).

12. Po kështu, jemi të mendimit se edhe korniza institucionale rezulton të jetë në funksion, pra të paraburgosurve u ofrohet shërbimi i kujdesit shëndetësor gjatë kohës së qëndrimit në institucion, përfshirë edhe spitalin e burgjeve. Lidhur me këtë, progresraporti i vitit 2023 i Komisionit Evropian për Shqipërinë, për sa i përket parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit, ka konstatuar se stafi mjekësor dhe ai mbikëqyrës në spitalet e burgjeve është përgjithësisht i kënaqshëm, si dhe nuk është raportuar asnjë keqtrajtim thelbësor në burgje ose nga policia, por Avokati i Popullit nënvizon nevojën për të përmirësuar standardet minimale për kushtet sanitare në burgje dhe mjediset policore (*shih faqet 29–30 të progresraportit*).

13. Së dyti, shtetit i lind detyrimi të ofrojë jo vetëm kujdesin e duhur mjekësor, por ai duhet të jetë i përshtatshëm, i plotë dhe efektiv. Në rastin konkret, konstatojmë se pas paraqitjes së kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, gjykata e shkallës së parë ka caktuar një grup ekspertësh të Institutit të Mjekësisë Ligjore për kryerjen e aktit të ekspertimit për gjendjen shëndetësore të kërkuesit. Në përfundim, ekspertët kanë konkluduar përpara gjykatës se "*gjendja aktuale shëndetësore e të hetuarit Lefter Koka, është veçanërisht e rëndë. Sëmundjet nga të cilat vuan shtetasi Lefter Koka nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit, në ambientet e IEVP, në të cilat ndodhet. Qëndrimi në izolim, në kushtet e paraburgimit, referuar diagnozës së të hetuarit, përbën rrezik për shëndetin e tij"*. Pavarësisht këtij konkluzioni, gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se sëmundjet që i janë diagnostikuar kërkuesit mund të ndikojnë në gjendjen e tij shëndetësore kudo që të ndodhet, pasi trajtimi i tyre është i njëjtë si në kushtet e paraburgimit, ashtu edhe në mjediset e tjera, prandaj nuk ka vend për zbutjen e masës. Lidhur me këtë, shumica është shprehur se Gjykata e Lartë ka arsyetuar vazhdimin e masës së sigurimit duke konsideruar kushtet mjekësore të kërkuesit, nuk është provuar pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese, qoftë në institucionin mjekësor kur trajtohen të paraburgosurit, ashtu edhe në një institucion të specializuar mjekësor, si dhe verifikimi i vazhdimësisë së masës së arrestit në burg është në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore.

14. Nuk pajtohemi me këtë arsyetim, pasi nisur nga përmbajtja e këtij akti dhe mënyra se si janë shprehur gjykatat, të cilat nuk e kanë konsideruar atë bindës, atyre u lindte detyrimi për të kërkuar një ekspertim të ri, i cili do të përcaktonte nëse kushtet konkrete përputheshin ose jo me kriteret e ligjit procedural penal për zëvendësimin e masës së sigurimit.

15. Gjithashtu, nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore rezulton se gjykatat nuk kanë kryer hetim në lidhje me përshtatshmërinë e trajtimit mjekësor brenda mjediseve të burgimit, por janë mjaftuar me trajtimin teorik të legjislacionit procedural penal. Thjesht parashikimi në ligj i të drejtave të individit nuk garanton edhe përmbushjen e standardit, pasi ajo që merr rëndësi është zbatimi efektiv në praktikë i tyre. Thënë kjo, gjykatat nuk u kanë kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuesit, të cilat mbështeteshin në një masë edhe nga konkluzionet e ekspertëve. Ato kishin detyrimin për të arsyetuar në mënyrë shteruese shkakun se përse nuk kanë pranuar të mbështesin vendimmarrjen e tyre në aktin e ekspertimit, me qëllim përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit. Përkundër kësaj, gjykatat janë mjaftuar me një arsyetim të përgjithshëm dhe abstrakt, i cili nuk i përgjigjej rastit konkret. Një mangësi e tillë nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë, e cila, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, duhej të shprehej në lidhje me këtë qëndrim të mbajtur nga gjykatat më të ulëta. Për pasojë, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se vendimet gjyqësore kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit.

16. Për më tepër, konstatojmë se gjykatat kanë refuzuar të mbështeten te mendimi i ekspertëve me arsyetimin se ai nuk është detyrues dhe sëmundjet me të cilat është diagnostikuar se vuan kërkuesi mund të ndikojnë në gjendjen e tij shëndetësore, pavarësisht vendndodhjes së tij, kudo që të ndodhet, në mjediset e shtëpisë, në mjediset e IEVP-së, ose në Institucionin e Veçantë të Kujdesit Shëndetësor të të Burgosurve. Në këtë drejtim, duhet evidentuar se gjykatat kanë shmangur lehtësisht mendimin e

specializuar të ekspertëve mjekoligjorë, pa marrë në konsideratë faktin se këta të fundit janë pjesë e Institutit të Mjekësisë Ligjore, i cili është një institucion qendror buxhetor, në varësi të ministrit të Drejtësisë që ka nën përgjegjësinë e tij, ndër të tjera, kryerjen e ekspertimeve mjekoligjore, si dhe veprimeve të tjera, në përputhje me legjislacionin procedural penal.

17. Për sa më lart, vlerësojmë se autoritetet shtetërore dhe gjykatat kanë dështuar në përmbushjen e detyrave të tyre për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të kërkuesit në përputhje me garancitë kushtetuese, duke vënë në dyshim mbi të gjitha trajtimin njerëzor të të paraburgosurit.

18. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi ishte i bazuar, ndaj Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e kërkesës.

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari

KËRKESË
Nr. 682/6, datë 19.6.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Zgjerimi i varrezave të qytetit Fushë-Krujë'", me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 624,512 (gjashtëqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Krujë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit "arë" dhe "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë";

- Për pasurinë "objekt banimi", është bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Krujë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 624,512 (gjashtëqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I DREJTORISË
SË NEGOCIMIT DHE ASISTENCËS
LIGJORE
Denada Dosti

LISTA EMËRORE E PRONARIT, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILIT SHPRONËSOHET PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT FUSHË-KRUJË"

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimi për shpronësim				
											"Arë"			Vlera totale në (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
1	Shpetim	Shaban	Babaj	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	247/3	Arë	2000	4	16	2000	287	574000	574000	
2	Saba	Haxhi	Tali	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	246/6	Arë	4600	5	56	3	287	861	861	
3	Saba	Haxhi	Tali	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	246/7	Arë	4000	5	54	173	287	49651	49651	
4	Shtet			Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	385	Rrugë	2800	9	80	1	0	0	0	
5	Shtet			Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	247/1	Arë	1200	7	249	1200	0	0	0	
6	Shtet			Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	247/2	Arë	900	8	1	900	0	0	0	
Vlera totale														624,512	
Çmimet janë marrë nga harta e vlerës, miratuar me VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016															

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/06/24 13:02:32 +02'00'
4d8d8833a9024a0ea1d5c5205d33894620240624
13022164031

Çmimi 352 lekë

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)